

... të fëmijëve në transmetime
... esën e Autoritetit të Media
... ive që prej muajit prill ka
... tur më **Buletini i** shumë
... mendime **Lëshillit të** për
... cilave kanë **Ankesave.** "N
... të drejtë të kërkojë, të het
... të marrë dhe të ndajë info
... dhe ide, pa asnjë lloj censa
... dios, tu dhe mjeteve të tjer
... ikimit audioviziv apo ndo
... tjetër bazuar në përzgjed
... m nëse këtë e bën në kuad
... timit të sundin
... tave të njeriut.
... me krijimin e shërbimeve



AUTORITETI I
MEDIAVE
AUDIOVIZIVE

Nr. 13

Përmbajtja

Hyrje	6
SEKSIONI I	
Administrimi i ankesave të qytetarëve apo grupeve të ndryshme të interesit në adresë të Ofruesve të Shërbimeve Mediatike Audiovizive	9
SEKSIONI II	
Ankesa me objekt "cenimin e rregullave të etikës dhe dinjitetit"	15
SEKSIONI III	
Ankesa me objekt "cenimin e të drejtave të fëmijëve"	47
SEKSIONI IV	
Komunikime tregtare të ndaluara	64
SEKSIONI V	
Ankesa jashtë afati	67
SEKSIONI VI	
Ankesa jashtë objektit të veprimtarisë	72

Dy fjalë

në vend të hyrjes

Çështja e respektimit të dinjitetit njerëzor si një e drejtë themelore e çdokujt në transmetimet audiovizive vijon të mbetet gjithmonë e më sfiduese në një mjedis mediatik të mbushur me filluska e filtra informacioni e që orientohet drejt lajmit sensacional dhe klikimeve.

Cënimi i mbrotjes së të drejtave të të miturve dhe shkeljet e konstatuara në mjedisin e sotëm të transmetimeve audiovizive lidhur me to mbetet një shqetësim prioritar për Këshillin e Ankesave që shkon përtej zbatueshmërisë së legjislacionit në fuqi dhe sanksioneve të forta ligjore.

Mbikëqyrja e zbatimit të Kodit të Transmetimit të miratuar nga AMA për çështje që lidhen me respektimin e dinjitetit dhe të drejtave themelore të njeriut, në mënyrë të veçantë mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në programet audiovizive është kompetencë dhe detyrë e Këshillit të Ankesave dhe përbën parimin më të rëndësishëm të Kodit të Transmetimit që e vendos median në shërbim të fëmijëve.

Shërbimet në tërësi që ofrojnë subjektet audiovizive mbështeten në kuadrin ligjor ndërkombëtar dhe kombëtar të çdo vendi, bazuar mbi praktikën më të mira dhe standardet perëndimore, që progresojnë me kohën dhe shqyrtimit të rasteve konkrete ligjore. Mbështetur në ligjin nr. 97/2013 "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë", ndryshuar dhe Kodit të Transmetimit, këto rregulla apo norma

morale dhe etike lidhen sidomos me procesin e edukimit cilësor mediatik përmes ofrimit të një shërbimi me përmbajtje vle-rash dhe normash që respektojnë kërkesat morale dhe ligjore për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Buletini i Këshillit të Ankesave si udhëzues i përmbajtjes së programeve audiovizive, është një dokument zyrtar në të cilin raportohen rezultatet e ankesave të shqyrtuara nëpërmjet të cilave referohen shkeljet e parimeve, rregullave, kërkesave dhe praktikave të transmetimeve audiovizive në Republikën e Shqipërisë.

Buletini i 13-të i Këshillit të Ankesave përmban ankesat e trajtuara për periudhën Maj - Dhjetor 2022, kohë që përkon me konstituimin e Këshillit të Ri të Ankesave në Maj të vitit 2022.

1

Administrimi i ankesave të

qytetarëve apo grupeve të


ndryshme të interesit në adresë

të Ofruesve të Shërbimeve

Mediatike Audiovizive

1. Administrimi i ankesave të qytetarëve apo grupeve të ndryshme të interesit në adresë të Ofruesve të Shërbimeve Mediatike Audiovizive

Përputhur me detyrimin e vet ligjor dhe rekomandimin përkatës të Kuvendit të Shqipërisë, Këshilli i Ankesave ka vijuar të shqyrtojë ankesat e mbërritura në institucion në adresë të OSHMA-ve, bazuar në ligjin nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, apo aktet nënligjore në fuqi.




1.1. Statistika

Gjatë vitit 2022, Këshilli i Ankesave ka administruar 310 ankesa, të dërguara respektivisht:

- 3% - nga mediat
- 9% - nga bizneset
- 9% - nga shoqëria civile
- 27% - nga institucionet
- 52% - nga individë

Ankesat e paraqitura kanë pasur për objekt:

- 32 % - shkeljen e të drejtave të fëmijëve, privatësisë së tyre;
- 38 % - shkeljen e të drejtave të njeriut dhe etikës së komunikimit
- 15 % - jashtë objektit të AMA-s, përcaktuar nga ligji nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;
- 2 % - të drejtën e përgjigjes;
- 13 % - të ndryshëm.



Në 54,5% të rasteve, KA ka konkluduar me "tërheqje vëmendjeje", 15% e tyre kanë qenë jashtë objektit të punës së KA/AMA-s, ndërkohë që në rastet e tjera (20.5%) vendimmarrja e KA ka shkuar në favor të lirisë së shprehjes.



1.2. Masa administrative (Me propozim të Këshillit të Ankesave, Autoriteti i Mediave Audiovizive ka vendosur dy gjopa ndaj subjekteve audiovizive kombëtare për shkelje të ligjit nr.97/2013 "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë")

- Gjopa e parë u vendos për përmbajtje antisemitike. Në emision komentet e të ftuarit dhe drejtuesit të emisionit nxisnin intolerancën, justifikonin dhunën dhe diskriminimin racor dhe nuk respektonin rregullat e etikës në cenim të parimeve themelore për veprimtarinë e transmetimeve audiovizive.
 - Gjopa e dytë u vendos ndaj një emisioni i cili ishte gjetur me shkelje të përsëritura si: fyerje, stigmatizim, diskriminim, vulgaritet dhe tone të pakontrolluara komunikimi. Para-léisht me këto shkelje, në një nga episodet e emisionit, fyerjet dhe diskriminimi kishin përfunduar edhe në dhunë.
- **Në muajin Korrik 2022**, AMA dënoi, me propozimin e KA, me gjobë një **subjekt audioviziv kombëtar**, për shkelje të ligjit Nr.97/2013 "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar për përmbajtje antisemitike. Komentet e të ftuarit dhe drejtuesit të emisionit nxisnin intolerancën, justifikonin dhunën dhe diskriminimin racor dhe nuk respektonin rregullat e etikës në cenim të parimeve themelore për veprimtarinë e transmetimeve audiovizive dhe ishin në shkelje të dispozitave ligjore, përkatësisht :
-
- Neni 4, "Parimet themelore për veprimtarinë e transmetimeve audiovizive", pika 2/d: "moslejimi i transmetimeve që nxisin intolerancën ndërmjet shtetasve" dhe 2/dh: "moslejimi i transmetimeve që nxisin ose justifikojnë dhunën",
 - Neni 32, "Rregulla të përgjithshme për ofruesit e shërbimeve mediatike audio dhe/ose audiovizive", pika 4 "OSHMA-të nuk transmetojnë programe me përmbajtje që të nxisin urrejtjen mbi baza racore, gjinie, fetare, etnike, kombëtare dhe çdo forme tjetër diskriminimi".

- Neni 33, "Detyrimet e OSHMA-ve", pika 1/a: "të njoftojë dhe të paraqesë lajmet e transmetuara në një mënyrë të vërtetë, të paanshme dhe objektive", pika 1/b: "të sigurojë që trajtimi i ngjarjeve, përfshirë çështjet, që janë tema të debatit publik, të jetë i drejtë për gjitha subjektet e interesuara në këto çështje dhe të paraqitet në mënyrë të vërtetë dhe të paanshme" dhe pika 1/ç: "të mos cenojë dinjitetin dhe të drejtat themelore të njeriut".
- **Në muajin Dhjetor 2022**, Këshilli i Ankesave pranë AMA-s propozoi gjobë ndaj një **subjekti audioviziv kombëtar**, pasi në emision kishte pasur në mënyrë të përsëritur shkelje etike, si: fyerje, stigmatizim, diskriminim, vulgaritet dhe tone të pakontrolluara komunikimi, të cilat kanë përfunduar edhe në dhunë, për të cilat Autoriteti i Mediave Audiovizive, AMA ka reaguar edhe me herët me disa tërheqje vëmendjeje (nr.3607prot., dt. 11.11.2021, nr.408prot., dt. 20.01.2022, nr.3755/1prot., dt. 17.11.2022).

1.3. Thirrje/Sensibilizime

- **(Maj 2022) Një subjekti audioviziv kombëtar**, iu sollën në vëmendje detyrimet e OSHMA-ve (ligji nr. 97/2013, i ndryshuar, neni 33, pika 1/ç) **për respektimin e diversitetit dhe promovimin e personave me aftësi të kufizuara**.
- **(3 Qershor 2022) Një subjekti audioviziv kombëtar** iu bë thirrje për **shmangien e skenave të papërshtatshme dhe vendosjen shenjave paralajmëruese në oraret që mund të ndiqen nga fëmijët**.
- **(17 Korrik 2022)** Paralelisht iu është tërhequr vëmendja 9 OSHMA-ve (**subjekte audiovizive kombëtare dhe lokale/rajonale**) për shkelje të ligjit nr.97/2013 "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar për **publikimin e të dhënave sensitive që identifikuan të miturën e abuzuar**. Po kështu, iu bë thirrje Policisë së Shtetit, për mospublikim të të dhënave rrethanore në njoftimet për shtyp, në emër të interesit më të lartë të fëmijës.
- **(14 Shtator 2022) Një subjekti audioviziv kombëtar** iu sollën në **vëmendje kërkesat morale e ligjore për mbrojtjen e të miturve** (ligji nr.97/2013, i ndryshuar, neni 4, pika 1/b).
- **(24 Nëntor 2022) Operatorit publik** iu bë thirrje për **sensibilitet të shtuar** ndaj shprehjeve diskriminuese **ndaj komunitet rom/egjiptian** pavarësisht faktit, se gazetarja kishte reaguar dhe i ftuari kishte kërkuar ndjesë.
- **(24 Nëntor 2022) Një subjekti audioviziv kombëtar** iu rikujtuan detyrimet **përkitazi normave etike dhe deontologjisë së profesionit të gazetarit** pavarësisht natyrës investiguese të emisionit dhe kontributit shoqëror në zbardhjen e çështjes përkatëse.

- **(15 dhjetor 2022)** Një subjekti audioviziv lokal/rajonal iu soll në vëmendje **domosdoshmëria e trajtimit me kujdes dhe përgjegjësi të problematikave sensitive**, që lidhin diskutimin për fenë me atë për dhunën, me synim shmangien e keqkuptimeve dhe promovimin qoftë dhe të pandërgjegjshëm të sjelljeve që bien ndesh me ligjin.

1.4. Seanca dëgjimore

(Neni 52, pika 6 e ligjit 97/2013)

- Me Operatorin publik

Autoritetit të Mediave Audiovizive i mbërriti një ankesë me pretendimin se në datën 18.09.2022, ora 17:00, ishte transmetuar përmbajtje e papërshtatshme. Ankuesi pretendonte se një përmbajtje e tillë audiovizive ishte *“e paarsyeshme për transmetim sidomos për personazhin dhe për ato që ai shfaq në rrjete sociale të cilat bien në kundërshtim me kodin etik dhe moral të shoqërisë”*.

Pas shqyrtimit të materialit audioviziv, Këshilli i Ankesave zhvilloi një bisedë këshilluese me autorët e emisionit. Këshilli u kujtoi autorëve parimet dhe detyrimet e OSHMA-ve në përmbushje të misionit mediatik, nisur edhe nga fakti se këto formate televizive iu drejtohen kryesisht të rinjve dhe të rejave dhe se imazhi që iu përcillet atyre rrezikon që të shndërrohet në model sjelljeje edhe për të miturit, marr parasysh faktin se orari i e transmetimit dhe në disa raste përmbajtjet problematike, ku ndjekësit potencialë mund të jenë edhe të miturit. Në vijim të argumentimit të mësipërm, Këshilli i Ankesave pranë AMA-s, u kërkoi autorëve zbatimin e kërkesave të legjislacionit, me fokus kryesor mbrojtjen e interesit më të lartë të fëmijës dhe apeloj ata për rishikimin e çdo përmbajtje audiovizive në kuadër të zbatimit të dispozitave të ligjore në fuqi.

Gjatë kësaj periudhe, Këshilli i Ankesave ka zhvilluar gjithashtu edhe katër vëzhgime, nisur nga sensibiliteti i ngjarjeve/temave të trajtuara nga media, duke konkluduar në tri prej katër syresh me *“Tërheqje vëmendjeje”* për operatorët përkatës dhe dy seanca dëgjimore.

2

Ankesa me objekt

“cënimin e rregullave të

etikës dhe dinjitetit”

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
Dhjetëra ankues	MCNTV	"Arnautistan"	09.05.2022

1. Objekti i Ankesës

Dhjetëra ankues iu drejtuan Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive për emisionin "Arnautistan", të transmetuar në televizionin "MCN", në datën 06.05.2022. Ankuesit pretendonin se ishte shkelur pika 1.5 e Kodit të Transmetimit, miratuar nga Bordi i AMA-s, me vendimin 228, datë 11.12.2017, sipas të cilit "Transmetimet audiovizive nuk duhet të nxisin urrejtjen, intolerancën, diskriminimin ose të justifikojnë dhunën ndërmjet shtetasve, si një nga parimet themelore që përbëjnë bazën e zhvillimit të veprimtarisë audiovizive, e cila mbështetet në garantimin e lirisë dhe të pluralizmit të mjeteve të komunikimit audioviziv".

2. Administrimi i Ankesës

Në kuadër të administrimit të ankesave, Këshilli i Ankesave i kërkoi subjektit audioviziv "MCN TV" paraqitjen e pretendimeve. Në përgjigjen e vet, OSHMA-ja sqaroi se gazetari kishte ushtruar të drejtën e lirisë së shprehjes (sipas citimeve të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, GJEDNJ), duke u treguar në çdo moment i kujdesshëm, për të mos cenuar të drejtat dhe liritë e besimtarëve të fesë islame, si edhe duke u përpjekur ta trajtojë çështjen në terma të përgjithshëm

dhe në kuadër të një problematike sociale që tejkalonte bindjet fetare.

Përballë pretendimeve të ankuesve dhe pretendimeve të subjektit audioviziv, Këshilli i Ankesave këqyri me vëmendje episodin e emisionit "Arnautistan", nga ku konstatoi se:

- moderatori gjatë monologut të tij në studio, i cili siç paralajmërohej edhe mbyllej, trajtonte nga këndvështrimi personal, tematikën e besimit fetar në Shqipëri, fokusi i të cilit ishin ritualet e komunitetit mysliman, por jo vetëm.
- në fjalën e tij, gazetari ndalej, veçanërisht të marrëdhëniet e komuniteteve fetare me shoqërinë shqiptare, duke mos u përqendruar vetëm në traditat e njërit prej besimeve, por duke artikuluar një shqetësim mbarë-social përkitazi atyre segmenteve të shoqërisë shqiptare - para së gjithash politikanëve – ndaj të cilëve revoltohej dhe i akuzonte, se duke (keq)përdorur këto tradita dhe rite për interesat e tyre po nxinin dhunë fetare.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave vlerësoi se gazetari në asnjë moment nuk kishte përdorur shprehje

fyese apo diskriminuese, të cilat mund të nxisin ose justifikonin dhunën ndërmjet shtetasve por vetëm kishte artikuluar bindjet e tij personale në kuadrin e lirisë së shprehjes.

Referuar ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në parimet themelore për veprimtarinë e transmetimeve audiovizive (neni 4, pika 2/a) si dhe Kodi i Transmetimit, (miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 228 datë 11.12.2017), në seksionin 4 pikat 4.1 dhe 4.4, Këshilli i Ankesave nuk konstatoi shkelje.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
A.Sh	TV "Abc News"	"Piranjat"	14.05.2022

1. Objekti i Ankesës

Shtetasja A.Sh i drejtoi një ankesë Autoritetit të Mediave Audiovizive, duke pretenduar se në emisionin "Piranjat", transmetuar në televizionin "Abc News", në datën 10.05.2022 ishin cenuar të drejtat e të miturve si dhe kishte patur shkelje të etikës televizive, si pasojë e përdorimit të fjalorit të papërshtatshëm.

2. Administrimi i Ankesës

Nga shqyrtimi i përmbajtjes audiovizive, Këshilli i Ankesave evidentoi faktin se në episodin në fjalë, transmetuar në emisionin "Piranjat", përçohej mesazhi sensibilizues në mbrojtje të interesit publik, lidhur me rrezikun e abuzimit të të miturve nga pedofilët.

Pa mohuar faktin se në transmetim ishte transmetuar dhe denoncuar një komunikimin banal i papërshtatshëm, përmes të cilit këta të fundit i drejtoheshin të miturve, në mbrojtje të "zhvillimit fizik, mendor dhe moral të të miturve" AMA i kujtoi OSHMA-së nenin 33 pika 1 të Ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Si përfundim, Këshilli i Ankesave u tërhoqi vëmendjen autorëve të emisionit për nevojën e fshehjes ose tjetërsimit të fjalorit të komunikimit nëpërmjet telefonisë celulare, të ofruar në kuadrin e investigimit, për shkak të detajeve tejet sensitive për zhvillimin mendor dhe moral të fëmijëve.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
Me vet-inicim	TV "Top Channel"	"Më lër të flas"	14.05.2022

1. Objekti i Ankesës

Nisur nga reagimet e shumta dhe shqetësimi i opinionit publik ndaj një episodi të emisionit "Më lër të flas", transmetuar në televizionin "Top Channel" në datën 3 Qershor 2022, ora 21.00, në lidhje me perceptimin si "mesazhe seksuale" të disa sekuencave të përmbajtjes së tij, të transmetuara në një orar, kur mund të ndiqej edhe nga fëmijët, Këshilli i Ankesave bazuar në kërkesat e ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe të Kodit të Transmetimit, miratuar nga Bordi i AMA-s, me vendimin 228, datë 11.12.2017 shqyrtoi me vetinicism përmbajtjen audiovizive përkatëse.

2. Administrimi i Ankesës

Gjatë këqyrjes së materialit filmik, Këshilli i Ankesave evidentoi se gjatë emisionit me karakter argëtues, zhvillohej një lojë me personazhet e ftuara, gjatë së cilës vajzat spërkateshin me qumësht nga mikrofoni me të cilin këndonin. Sipas Këshillit, skena e sipërpërmendur linte vend për keqinterpretim.

Këshilli i Ankesave evidentoi gjithashtu:

- Shkelje të etikës së komunikimit përmes përdorimit të fjalorit banal

dhe të papër-shtatshëm në një orar që ndiqet nga fëmijët (ora 21.30), duke cenuar të miturit.

Konkretisht gjatë emisionit, nga moderatorët, ishin përdorur shprehje si "Erdhe gjithë f...", "Nuk të ngel hatri nëse të kthej pak b...", "Mendon se kanë b... këto ta bëjnë pa ne ...", etj.

Mungesë të shenjave paralajmëruese për programet që cenojnë të miturit. Ligji nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, detyron çdo Operator të Shërbimit Mediatik Audioviziv (OSHMA), të respektojë dispozitat ligjore që rrjedhin nga përcaktimet e (nenit 33, pika 1/d; neni 4, pika 1/b, si dhe neni 46).

Pavarësisht se në fillim të emisionit paralajmërohej me shkrim se "Në disa raste përmbajtja mund të jetë jo e përshtatshme për çdo audiencë!", emisioni nuk paraprihej nga një para-lajmërim akustik ose të identifikohet nga prania e një simboli viziv gjatë gjithë kohëzgjatjes së tij, siç përcaktohet në pikat 5.35; 5.40.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave konstatoi shkelje të Ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive

në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe të Kodit të Transmetimit, miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 228 datë 11.12.2017 dhe për pasojë, Këshilli i Ankesave i tërhoqi vëmendjen për shkelje të ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe të Kodit të Transmetimit, miratuar nga Bordi i AMA-s, me vendimin 228, datë 11.12.2017" si dhe i kërkoi:

- marrjen e masave teknike në të ardhmen për të shmangur në transmetimet tuaja fjalorin e

papërshtatshëm,

- vendosjen e shenjave paralajmëruese, sipas përcaktimeve të Kodit të Transmetimit në pikën 5.48 të tij,
- mostransmetimin e përmbajtjeve audiovizive që cenojnë rregullat e etikës dhe moralit publik dhe paralajmëroi, se në rast përsëritjeje, shkeljet do të penalizohen sipas sanksioneve të përcaktuara në Ligjin nr.97/2013 "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit	Albania News 24 MCN TV Syri TV	Kronikë informative
		Data 1.1.2022

1. Objekti i Ankesës

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit i drejtoi Autoritetit të Mediave Audiovizive një ankesë, me pretendimin se publikimi i pamjeve të vrasjes së policit brenda ambienteve të komisariatit në Tiranë ishin tejet sensitive. Ankuesi pretendonte se pamjet ishin publikuar nga disa OSHMA, (Euronews Albania, News 24, MCN TV dhe Syri TV).

2. Administrimi i Ankesës

Pas këqyrjes së materialeve filmike, bazuar në verifikimin e monitorimeve të kryera nga AMA u evidentua se subjektet audiovizive (Euronews Albania, News 24, MCN TV dhe Syri TV) kishin transmetuar pamjet e skenës

së vrasjes së policit brenda komisariatit nr.3 pa përdorur teknologjinë e përshtatshme të mbulimit të tyre dhe në shkelje të ligjit nr.97/2013 "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar (neni 4 pika 2/ç), neni 33, pika dh), neni 46 pika 2/dh).

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Autoriteti i Mediave Audiovizive u tërhoqi vëmendjen OSHMA-ve për shkelje të Ligjit Nr.97/2013 "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe të Kodit të Transmetimit, miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 228 datë 11.12.2017, si dhe i kërkoi ndalimin e ritransmetimit dhe fshirjen e pamjeve filmike pa përdorur teknologjinë e përshtatshme të mbulimit të tyre.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
E.N	TV "Abc News"	"Piranjat"	01.06.2022

1. Objekti i Ankesës

Shtetasja E.N i drejtoi një ankesë Këshillit të Ankesave, me pretendimin se në emisionin "Piranjat", transmetuar në televizionin "Abc News", në datën 27.05.2022, "gazetarët tentonin të vënë "drejtësinë" në vend për nusen, duke filmuar në shtëpi... pa leje dhe duke i detyruar të dalin me imazh dhe audio në intervista të pakërkua".

2. Administrimi i Ankesës

Pas shqyrtimit të përmbajtjes audiovizive, Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive konstatoi shkelje të Ligjit Nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe të Kodit të Transmetimit, respektivisht në (neni 4, pika 2/ç, d, dh) si dhe (neni 33, pika 1/ç, d, dh)

Dhe vlerësoi, se shkelja e hapësirës private të familjes në fjalë nga ana e gazetares,

duke qenë se:

- nuk i shërben investigimit – sepse nuk ofron fakte dhe të dhëna të reja në shërbim të sqarimit të sfondit të ngjarjes,
- nuk i shërben interesit publik, sepse nuk i ndih mospërsëritjes së ngjarjes parardhëse, por përkundrazi bëhet vetë protagonist i një situatë të ngjashme, duke e promovuar padashur atë, përbën shkelje të etikës profesionale dhe kodit të deontologjisë së gazetarit duke cënuar kuptimin publik të misionit të tij.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave i tërhoqi vëmendjen subjektit audioviziv "Abc News" për emisionin "Piranjat" për shkelje të Ligjit nr.97/2013 "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe të Kodit të Transmetimit, miratuar nga Bordi i AMA-s, me vendimin 228, datë 11.12.2017.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
A.P	TV "Klan"	"Stop"	06.06.2022

1. Objekti i Ankesës

Shtetasja A.P i drejtoi një ankesë Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive, me pretendimin se në emisionin "Stop", transmetuar në televizionin "Klan", në datën 26.05.2022, ora 20:05, ishte publikuar një lajm i pavërtetë lidhur me një konflikt pronësie. Sipas ankueses, lajmi i transmetuar i kishte cenuar imazhin dhe dinjitetin e saj.

2. Administrimi i Ankesës

Në kuadër të trajtimit të ankesës OSHMA-së iu kërkua paraqitja e pretendimeve. Subjekti audioviziv "Tv Klan", në përgjigjen e vet sqaruan se "Emisioni "Stop" dhe stafi i tij gjatë trajtimit të ankesës ka patur të gjithë kujdesin e duhur që informacioni të jetë i saktë dhe në përputhje të plotë me

dokumentet zyrtare e vëna në dispozicion nga palët dhe deklaratimet e personave të tjerë të lidhur me çështjen, me fokus kryesor informimin e publikut në lidhje me çështjen që trajtohej në emision".

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Passhqyrtimit të pretendimeve të mbërritura dhe këqyrjes së përmbajtjes audiovizive, Këshilli i Ankesave evidentoi se raportimi i gazetarit ishte korrekt, profesional dhe i referohej dokumenteve zyrtare të lëshuara nga institucionet e Republikës së Shqipërisë, duke realizuar misionin e gazetarisë për informimin e qytetarëve në lidhje me çështje që përbënin interes publik. Si përfundim, Këshilli i Ankesave nuk konstatoi shkelje të Ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe të Kodit të Transmetimit (miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 228 datë 11.12.2017).

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
B.B	TV "Klan"	"Stop"	17.06.2022

1. Objekti i Ankesës

Përmbaruesi B.B i drejtoi një ankesë Këshillit të Ankesave, pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive, me pretendimin se disa episode të emisionit "Stop", transmetuar në televizionin "Klan", në datat; 07.04.2022; 26.05.2022; 08.06.2022; 16.06.2022, ishin trajtuar çështje duke "shtrembëruar faktet, keqinformuar publikun dhe duke denigruar aktivitetin si përmbarues gjyqësor privat".

2. Administrimi i Ankesës

Në kuadër të administrimit të ankesës, Këshilli i Ankesave bazuar në nenin 51 të ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, rregullores "Mbi procedurat për shqyrtimin e ankesave nga Këshilli i Ankesave dhe të drejtës së përgjigjes" si dhe udhëzimit "Mbi procedurat e trajtimit të ankesave nga Ofruesit e Shërbimit Mediatik Audioviziv", i kërkoi OSHMA-së paraqitjen e pretendimeve.

Në përgjigjen e vet subjekti audioviziv, televizioni "Klan", sqaroi se "të gjitha momentet e konflikteve të trajtuara nga STOP pasqy-

roheshin me fakte dhe informacione të bazuara në dokumente zyrtare, intervista dhe/apo deklarime të personave të përfshirë në çështje, apo videoregjistrime të fshehta të realizuara gjatë investigimit të rastit. Në asnjë moment, në asnjë rast nuk ka manipulime të provave apo dokumenteve dhe aq më tepër shantazhim të ndonjë pale të caktuar".

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Pas shqyrtimit të pretendimeve të të dyja palëve dhe këqyrjes së materialit filmik, Këshilli i Ankesave evidentoi se raportimi i gazetarit ishte korrekt, profesional dhe referuar dokumenteve zyrtare të lëshuara nga institucionet e Republikës së Shqipërisë duke realizuar misionin e gazetarisë për informimin e opinionit në lidhje me çështje që përbëjnë interes publik.

Si përfundim, Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive nuk konstatoi shkelje të Ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe të Kodit të Transmetimit (miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 228 datë 11.12.2017).

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
"Superbeton Mat", sh.p.k	TV "Klan"	"Stop"	20.06.2022

1. Objekti i Ankesës

Përfaqësues të shoqërisë "Superbeton Mat" sh.p.k, i drejtuan një ankesë Këshillit të Ankesave, me pretendimin se në emisionin "Stop", transmetuar në televizionin "Klan" në datën 08.06.2022 ishin "deformuar tërësisht faktet e ndodhura dhe provat shkresore ... duke cenuar pa të drejtë imazhin e tyre".

Sipas OSHMA –së, "Në asnjë rast në emisionin e sipërcituar nuk bëhet me faj ankuesi, emri i të cilit citohet në minimumin e mundshëm, pasi çështja është ligjore dhe trajtohet në të tjera institucione".

Pas shqyrtimit të pretendimeve të mbërritura dhe këqyrjes së vëmendshme të materialit filmik, Këshilli i Ankesave evidentoi se përmbajtja audiovizive ishte trajtuar konform përcaktimeve ligjore të nenit 4, pika 1/ç, si dhe nenit 33, pika 1/b).

2. Administrimi i Ankesës

Në vijim të trajtimit të ankesës, Këshilli i Ankesave i kërkoi Bordit të Shqyrtimit të Ankesave të OSHMA-së paraqitjen e pretendimeve. Në përgjigjen e vet, televizioni "Klan" sqaroi se "Emisioni "Stop" dhe stafi i tij gjatë trajtimit të ankesës kishte patur gjithë kujdesin e duhur që informacioni të jetë i saktë dhe në përputhje të plotë me dokumentet zyrtare të vëna në dispozicion nga banorët, duke patur si qëllim kryesor informimin e publikut për çështjen konkrete".

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave konkludoi se, raportimi i gazetarit ka qenë korrekt, profesional dhe i referohej dokumenteve zyrtare të lëshuara nga institucionet e Republikës së Shqipërisë duke realizuar misionin e gazetarisë për informimin e opinionit në lidhje me çështje që përbëjnë interes publik, si e tillë nuk ka shkelje të Ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe as të Kodit të Transmetimit, miratuar nga Bordi i AMA-s, me vendimin 228, datë 11.12.2017 .

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
I.N	TV "Top Channel" TV "Vizion Plus" TV "Klan"	Intervista Kronikë informative Kronikë informative	21.06.2022

1. Objekti i Ankesës

Shtetasja I.N i drejtoi një ankesë Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive, ndaj disa televizioneve: "Top Channel", "Vizion Plus", "Klan", lidhur me transmetimin në edicionet e lajmeve; të intervistës së gazetares S.GJ, në emisionin "Top Story" si dhe videove të protestës së datës 23.11.2018. Ankuesja kërkonte "bllokimin dhe mostransmetimin e videove, materialeve apo çfarëdolloj materiali tjetër për figurën time", nisur nga funksioni i punës që kryen.

2. Administrimi i Ankesës

Që me marrjen e ankesës, u konstatuoi se

- ankesa ishte jashtë afateve ligjore të parashikuara nga legjisllacioni në fuqi për administrimin e saj. Referuar ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, konkretisht neni 52, "Shqyrtimi i ankesave", sanksionon se "Ankesa duhet të paraqitet në formë të shkruar në Këshillin e Ankesave brenda 30 ditëve nga data

e transmetimit, ose kur në rastin e dy ose më shumë transmetimeve të lidhura me njëra-tjetrën, nga data e transmetimit më të vonë".

- ndërsa kërkesa për fshirjen e materialeve video, jashtë juridiksionit të Autoritetit të Mediave Audiovizive, referuar ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, konkretisht neni 2, "Fusha e zbatimit", përcakton se "Ky ligj zbatohet për transmetimet audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare dhe shërbimet mbështetëse të tyre. Ky ligj nuk zbatohet për median e shkruar".

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave e informoi ankuesen se ankesa ishte jashtë afateve ligjore të parashikuara nga legjisllacioni në fuqi për administrimin e saj dhe se publikimi në mediat online dhe median e shkruar dilte jashtë juridiksionit të Autoritetit të Mediave Audiovizive, referuar ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
H.Gj	TV "Klan"	"Stop"	27.06.2022

1. Objekti i Ankesës

Pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive mbërriti një ankesë nga H. Gj në lidhje me emisionin "Stop", të transmetuar në televizionin "Klan", në datën 23.06.2022 ora 20:05. Ankuesi pretendonte se në emision "janë dhënë konsiderata fyese dhe tërësisht të njëanshme".

2. Administrimi i Ankesës

Për trajtimin e ankesës, Këshilli i Ankesave i kërkoi subjektit audioviziv televizioni "Klan" paraqitjen e pretendimeve. Në përgjigjen e vet OSHMA-ja sqaroi se "gjatë trajtimit të saj ka patur të gjithë kujdesin e duhur që informacioni të jetë i saktë dhe në përputhje të plotë me dokumentet zyrtare dhe deklaratimet e vëna në dispozicion nga vetë ankuesit dhe nga persona të tjerë të lidhur me çështjen (avokati, palë të treta etj.), duke patur si qëllim kryesor informimin e publikut për çështjen konkrete".

Pas shqyrtimit të pretendimeve të mbërritura nga subjekti audioviziv dhe këqyrjes së materialit filmik, Këshilli i Ankesave evidentoi se emisioni "Stop" i datës 23.06.2022, gazetari kishte vepruar në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga dispozitat ligjore të ligjit nr.97/2013 "Për median audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar (neni 4, pika 1/ç; neni 33, pika 1/b).

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave konstatoi se raportimi i gazetarit ishte korrekt, profesional dhe u referohej fakteve dhe informacioneve bazuar në dokumente zyrtare, intervista dhe deklaratime të personave të përfshirë në çështje apo ekspertë të fushës duke garantuar një informim objektiv dhe të paanshëm të publikut për çështje tejet sensitive.

Si përfundim, Këshilli i Ankesave nuk konstatoi shkelje të Ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe të Kodit të Transmetimit, (miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 228 datë 11.12.2017).

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme (përcjellëse e notës verbale të Ambasadës së Izraelit në Tiranë)		TV "Top Channel" / "E diell"	30.06.2022

1. Objekti i Ankesës

Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme i përcolli Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA-s) një notë verbale të Ambasadës së Izraelit në Tiranë, në lidhje me rubrikën "Rrethi Katror", të emisionit "E diell", transmetuar në televizionin "Top Channel", në datën 05.06.2022. Përmes shkresës, selia diplomatike, pretendonte se të ftuarit në këtë emision kishin dhënë mesazhe kundër hebrenjve, ndërsa theksohej se drejtuesi i emisionit nuk kishte ndërhyrë në asnjë moment.

2. Administrimi i Ankesës

Këshilli i Ankesave, pasi mori në shqyrtim përmbajtjen audiovizive, konstatoi se i ftuari kishte bërë deklaratë dizinformuese por edhe diskriminuese, të cilat jo vetëm kalonin pa reagim nga ana e drejtuesit të emisionit, por merrnin edhe mbështetjen e

tij, ndonëse njëri prej të ftuarve bënte thirrje për përgjegjësi ndaj audiencës.

Gjatë këqyrjes së materialit filmik, Këshilli i Ankesave vlerësoi gjithashtu se deklarime të tilla ishin në shkelje të ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar përkatësisht në: nenit 4, pika 2/d dhe 2/dh; në nenin 32, pika 4 si dhe në nenin 33, pika 1/a, 1/b: dhe 1/ç.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Si përfundim, Këshilli i Ankesave, kontatoi se shkelja e parimeve dhe normave të ligjit për mediat audiovizive dhe Kodit të Transmetimit, miratuar nga Bordi i AMA-s, me vendimin 228, datë 11.12.2017 gjatë këtij transmetimi përbënte nxitje të urrejtjes mbi baza nacionale dhe, si e tillë, dënohet me ligj. Këshilli i Ankesave i propozoi Bordit të AMA-s sanksionimin me gjobë të OSHMA-së, propozim i cili u miratua.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
K.E	TV "EuronewsAlbania"	Edicion informativ	12.07.2022

1. Objekti i Ankesës

Pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) mbërriti një ankesë, sipas së cilës, në programin "Euronews Tonight" transmetuar në televizionin "Euronews Albania", në datën 12.07.2022 në vox-pop një qytetar, duke iu referuar papastërtive në bregdet, nëpërmjet krahasimit me komunitetin rom, përdori termin keqësues "arixhinj". Ankuesi pretendonte se kishte kontaktuar me median por se "nuk është marrë asnjë masë prej tyre për të fshirë apo redaktuar materialin".

2. Administrimi i Ankesës

Këshilli i Ankesave këqyri përmbajtjen audiovizive nga ku vuri re se gjatë kronikës, një pushues i intervistuar nga gazetari, shprehej në mënyrë diskriminuese ndaj personave me ngjyrë, duke përdorur shprehje si, "...s'jam racist por si arixhinj punojnë... ja pisllek i madh këtu..." për të ilustruar mendimin

e tij mbi situatën e ndotjes në bregdetin e Durrësit.

Sipas ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar OSHMA-të në transmetimet e tyre duhet të respektojnë detyrimet ligjore që rrjedhin nga (neni 32, pika 4, neni 33, pika 1/ç) dhe përcaktimet të cilat sanksionohen edhe në Kod të Transmetimit, si akti nënligjor më i rëndësishëm për mediat audiovizive, i ndalon transmetimet që nxisin diskriminimin (pika 1.5 dhe 4.8 e Kodit të Transmetimit).

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Bazuar në sa më sipër, Këshilli i Ankesave konstatoi shkelje të Ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe të Kodit të Transmetimit, miratuar nga Bordi i AMA-s, me vendimin 228, datë 11.12.2017, ndaj i tërhoqi vëmendjen subjektit audioviziv si dhe i kërkoi atij editimin/korrektimin e materialit filmik në kanalën zyrtar në Youtube.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
Komisioneri për të Drejtën e Informimit Portale, rrjete sociale dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale		Shkrime	20.07.2022

1. Objekti i Ankesës

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale i drejtoi një ankesë Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive, ku i kërkonte marrjen e masave për ndalimin e transmetimit dhe përpunimit të paligjshëm të të dhënave personale të zj. D.D, në disa medime (media online apo rrjete sociale).

2. Administrimi i Ankesës

Gjatë administrimit të ankesës, u evidentua se materialet e referuara nga ankesa e Komisionerit për të Drejtën e Informimit

dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale i referoheshin veprimtarisë së mediave online, të cilat nuk janë në juridiksion të AMA-s, referuar nenit 2 të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Kërkesa e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale nuk mund të trajtohet nga ana Autoritetit të Mediave Audiovizive, pasi mosrespektimi i kërkesave të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale si dhe medimet përmes të cilave kjo shkelje ishte konsumuar, dilte jashtë tagrit institucional të autoritetit.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
Bordi i AMA-s	TV "Klan"	"Opinion"	28.07.2022

1. Objekti i Ankesës

Në mbledhjen e datës 28.07.2022, Bordi i Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) ngriti shqetësimin se në emisionin "Opinion", transmetuar në televizionin "Klan" më datë 05.07.2022 ishte bërë "hapur propagandë komuniste...ish-funksionarë deklarojnë të pavërteta duke prekur sensibilitetin e njerëzve (viktima të sistemit) që janë ende gjallë dhe të pasardhësve të tyre".

2. Administrimi i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive nga këqyrja e materialit filmik, konkretisht emisionit "Opinion", të datës 05.07.2022 të transmetuar në televizionin "Klan", evidentoi se tema e trajtuar kishte lidhje me periudhën e regjimit komunist në Shqipëri, ndërsa në qendër të emisionit ishte intervista e një ish-funksionari të lartë të atij regjimi, i cili rrëfente fakte dhe dëshminë e tij personale, në lidhje me periudhën në fjalë.

Në vazhden e trajtimit të ankesës, si dhe duke u bazuar në nenin 51 të Ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; rregullores "Mbi procedurat për shqyrtimin e ankesave nga Këshilli i Ankesave dhe të drejtës së

përgjigjes", si dhe udhëzimit "Mbi procedurat e trajtimit të ankesave nga Ofruesit e Shërbimit Mediatik Audioviziv", Këshilli i kërkoi OSHMA-së paraqitjen e pretendimeve lidhur me shqetësimin e Bordit të AMA-s.

Në kthim-përgjigjen e vet, televizioni "Klan" pretendoi se qëllimi i emisionit, lidhur me temën e trajtuar, ishte "hedhja dritë mbi faktet e këtyre dekadave si një dritare për personat që e jetuan atë periudhë por edhe për brezat e rinj. Personi që ka qenë në qendër të emisionit me intervistën e tij, ka shprehur me zë dhe figurë faktet sipas dijenisë së tij si një dëshmitar i kohës dhe në asnjë rast nuk pretendohet nga drejtuesi i emisionit se intervista përmban të vërteta absolute".

Gjatë shqyrtimit me vëmendje të përmbajtjes audiovizive të emisionit "Opinion", Këshilli i Ankesave nuk evidentoi ndonjë tendencë të moderatorit për të bërë "propagandë komuniste dhe vlerësoi se deklaratat e të intervistuarit, ish-funksionari i lartë i regjimit komunist, lidhen me rolin informues që ka televizioni për të pasqyruar dëshmi që lidhen me ngjarje historike, të cilat ishin konform përcaktimeve ligjore të Ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar (neni 4, pika 1/a; po aty pika 2/a & b).

Edhe Kodi i Transmetimit, hartuar dhe miratuar nga AMA, në seksionin e parë të

tij, si parime themelore që përbëjnë bazën e zhvillimit të veprimtarisë audiovizive, e cila mbështetet në garantimin e lirisë dhe të pluralizmit të mjeteve të komunikimit audioviziv, dispozita të cilat parashikohen në aktin nënligjor, në seksionin 4 pika 4.1 e Kodit të Transmetimit.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave nuk konstatoi shkelje të Ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe të Kodit të Transmetimit, miratuar nga Bordi i AMA-s, me vendimin 228, datë 11.12.2017.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
K.D	TV "Klan"	"Stop"	15.09.2022

1. Objekti i Ankesës

Shtetasi K.D i drejtoi një ankesë Autoritetit të Medias Audiovizive (AMA) në lidhje me emisionin "Stop", transmetuar në televizionin "Klan", në datat 06.09.2022 dhe 08.09.2022 ora 20:05. Në datat e referuara nga ankuesi trajtohej rasti i dyshuar i abuzimit të së miturës 10 - vjeçare nga një 77 - vjeçar. Ankuesi pretendonte se "Emisioni me mënyrën si e ka trajtuar ngjarjen, ka cenuar rëndë dinjitetin e personit duke e etiketuar tashmë si përndjekës dhe ngacmues seksual të fëmijëve, ndërkohë që procesi është ende në hetim".

2. Administrimi i Ankesës

Në vazhden e trajtimit të ankesës, Këshilli i Ankesave këqyri përmbajtjet audiovizive të emisioneve të transmetuara në datat 6 dhe 8 Shtator 2022, bazuar në dispozitat ligjore (neni 4, pika 2/ç, d dh) të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe seksioni 3, pika 3.4 i Kodit të Transmetimit, miratuar nga Bordi i AMA-s, me vendimin 228, datë 11.12.2017.

Edhe pse u mbajt në konsideratë kontributi investigues i emisionit "Stop" në trajtimin e temave tejet sensitive, ku synohej sensibilizimi i opinionit publik për dukuri problematike të shoqërisë, në kuadër të së cilës ishte edhe trajtimi i rastit të abuzimit të dyshuar të së miturës prej 77-vjeçarit, megjithatë Këshilli i Ankesave konstatoi se: "zbulimi i identitetit të të dyshuarit përmes publikimit të intervistës së tij me zë dhe figurë" – si edhe – "komentet e moderatorëve të emisionit, nëpërmjet të cilave i dyshuari etiketohet direkt ose indirekt si përndjekës dhe ngacmues seksual i fëmijëve pavarësisht se hetimi nuk ka përfunduar"; nuk përkonin me qëllimin e shpallur të trajtimit të çështjes, për të nxitur vijimin e hetimit dhe shqyrtimin e plotë të provave nga ana e hetuesisë.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave tërhoqi vëmendjen përkitazi dispozitave të sipërpërmendura të Ligjit nr.97/2013 "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe të Kodit të Transmetimit, miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 228 datë 11.12.2017 si i kërkoi respektimin e tyre në të ardhmen.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
-------------------------	---------------------	----------	------

Operatori i Sistemit të Transmetimit TV "News 24" (OST)	Edicion informativ	15.09.2022
---	--------------------	------------

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Medias Audiovizive (AMA) i mbërriti një ankesë nga Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST) për refuzimin e së drejtës së përgjigjes nga operatori audioviziv, në lidhje me një lajm të transmetuar në televizionin "News 24", në edicionet qendrore informative të orës 19:00, në datat 17.08.2022 dhe 18.08.2022. Ankesa i referohej një procedure tenderi të shpallur nga OST, për të cilin përfaqësuesit e OST-së pretendonin se ishte i pavërtetë, i pasaktë dhe plotësisht dizinformues. Sipas tyre "Transmetimi i këtij lajmi abuziv i cili ka dezinformuar në mënyrë të gjerë publikun cenon reputacionin e shoqërisë OST sh.a dhe prish imazhin e saj si një institucion i një rëndësie të veçantë".

2. Administrimi i Ankesës

Në kuadër të administrimit të ankesës, Këshilli i Ankesave i kërkoi subjektit audioviziv privat vendor "News 24" paraqitjen e pretendimeve. Pretendime të cilat u paraqitën në mënyrë zyrtare pranë Autoritetin e Mediave Audiovizive (AMA).

Bazuar në dokumentacionin në dispozicion dhe pretendimet e paraqitura nga televizioni

"News 24", Këshilli i Ankesave i dërgoi konstatimin e tij Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST), sipas të cilit "OSHMA kishte reaguar, duke ndërmarrë ndryshimin e përmbajtjes audiovizive përkatëse dhe pasqyruar reagimin e OST (ligji 97/2013, neni 53, pika 13/ë), përpara se OST t'i drejtohej me kërkesën për konsumimin e së drejtës së përgjigjes (ligji 97/2013, neni 53, pika 10)".

Pasi OST e refuzoi këtë konstatim, referuar ligjit, nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, sipas të cilit "...Këshilli i Ankesave mund të vendosë organizimin e seancave dëgjimore me palët" (neni 52, pika 6), Këshilli i Ankesave ftoi palët në një seancë dëgjimore, më datë 17.11.2022 ora 14:00, në zyrat e Autoritetit të Medias Audiovizive. Për shkak të afatit të ngushtë kohor dhe pamundësisë për pjesëmarrje, subjekti televiziv privat vendor "News 24" kërkoi shtyrje të seancës për një datë të dytë, me kohë të mjaftueshme për t'u përgatitur. Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive e shtyu seancën për datën 01.12.2022, ora 14:00.

Në seancën dëgjimore, e zhvilluar më datë 01.12.2022, ora 14:00 në zyrat e Autoritetit të Medias Audiovizive, të gjitha palët ishin pjesëmarrës. Edhe në këtë seancë dëgjimore, palët ishin të një mendjeje lidhur me faktin, që subjekti televiziv privat vendor "News 24" reagoi duke pasqyruar reagimin

e OST-së në lajm, dhe se informacionin verbal përkitazi reagimit të OST –së e kishin shoqëruar vizualisht me pamjet e reagimit të institucionit, bërë në rrjetet sociale. Përtej kësaj, palët evidentuan qëndrime të ndryshme, ku sipas përfaqësuesve të OST-së pasqyrimi i reagimit të sipërpërmendur nuk e kishte ndryshuar qasjen e lajmit dhe efektin përkatës të publiku. Ndërsa, sipas përfaqësuesit të "News 24", media reagoi me profesionalizëm dhe vullnet të mirë, së pari, sepse e kishte pasqyruar reagimin e OST-së menjëherë, ndonëse nuk i kishte ardhur zyrtarisht, por ishte publikuar vetëm në rrjetet sociale dhe së dyti, sepse nuk e kishte komentuar atë. Përfaqësuesit e OST-së këmbëngulën në pamjaftueshmërinë e reagimit të sipërpërmendur, ndërsa përfaqësuesi i "News 24" në pavarësinë editoriale të OSHMA-së.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Pas seancës dëgjimore dhe rishqyrtimit të pozicioneve, të paraqitura, Këshilli i Ankesave arriti në përfundimin se, palët nuk ofruan fakte dhe argumente shtesë në raport me qëndrimet e mëhershme dhe për rrjedhojë, ndaj i mbeti konstatimit të vet të mëhershëm, sipas të cilit OSHMA kishte reaguar, duke ndërmarrë ndryshimin e përmbajtjes audiovizive përkatëse, pasi kishte pasqyruar reagimin e OST (ligji 97/2013, neni 53, pika 13/ë), përpara se OST t'i drejtohej me kërkesën për konsumimin e së drejtës së përgjigjes (ligji 97/2013, neni 53, pika 10).

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
B.B	TV "Klan"	"Stop"	12.10.2022

1. Objekti i Ankesës

B.B, përmbarues privat i dërgoi një ankesë Këshillit të Ankesave pranë AMA-s, përmes së cilës pretendonte se në emisionin "Stop", transmetuar në televizionin "Klan", në datë 11.10.2022 ora 20:05 ndaj tij ishte bërë "sulm personal me prapavijë korruptive të fortë për të shkatërruar biznesin dhe jetën, me anë të dezinformimit".

2. Administrimi i Ankesës

Në këtë kuadër të administrimit të ankesës, Këshilli i Ankesave i kërkoi subjektit audioviziv "TV Klan" paraqitjen e pretendimeve.

Në përgjigjen e vet, TV Klan, sqaroi se: "Çështja e transmetuar në emision është bërë duke u bazuar në deklaratimet, dokumentat dhe vendimet e gjykatave të vëna në dispozicion nga qytetari dhe avokati i tij për STOP, akte të cilat janë shfaqur dhe publikisht gjatë transmetimit të rasteve. Nga ana e gazetarit në të dyja emisionet është kontaktuar dhe është kërkuar dhe opinionin i vetë përmbaruesit Besnik Bajraktari, i cili ka dhënë shpjegimet e veta për çështjet konkrete dhe qëndrimi i tij është bërë publik, duke qenë sa më të paanshëm".

Pas shqyrtimit të pretendimeve të mbërritura dhe këqyrjes së përmbajtjes audiovizive, Këshilli i Ankesave shqyrtoi evidentoi se emisioni "Stop" i datës 11.10.2022 trajtonte problematikën e një qytetari i cili vihej përballë një procedure përmbarimore të nisur nga përmbaruesi privat B.B (emisioni i datës 11 Tetor 2022). Nga shqyrtimi i materialeve, Këshilli i Ankesave konstatoi se raportimi i gazetarit ka qenë korrekt, profesional, referuar dokumentave, të publikuara edhe në emision, deklaratave të përmbaruesit privat si edhe përputhur me misionin informues të medias për çështje me interes publik. Trajtimi i një teme kaq sensitive, sikurse çështja e pronës, përmbajtja audiovizive ishte konform detyrimeve ligjore që rrjedhin nga ligji nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, nenit 4, pika 1/ç, dhe neni 33, pika 1/b.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave nuk konstatoi shkelje të Ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe të Kodit të Transmetimit, (miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 228 datë 11.12.2017).

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
S.D	TV "Klan"	"Stop"	14.10.2022

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave mori një ankesë nga shtetasja S.D, gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër në lidhje me emisionin "Stop", të transmetuar në televizionin "Klan", në datat 16.11.2021 dhe 12.10.2022. Ankuesja pretendonte se gazetarët e emisionit "në mënyrë të përsëritur, kanë kryer veprime dhe publikuar reportazhe të cilat cenonin figurën e saj si gjyqtare dhe si njeri....duke pasqyruar të dhëna të pasakta dhe informacion të rremë", -si dhe- "mënyra e të vepruarit, duke i dalë para me mikrofoni dhe kamera, duke i zënë rrugën.....përbënin veprime kërcënuese, kanosëse, me qëllimin e vetëm ushtrimin e ndikimit të paligjshëm, cenimin e integritetit të saj si njeri dhe gjyqtare".

2. Administrimi i Ankesës

Pas marrjes së ankesës, Këshilli i Ankesave shqyrtoi përmbajtjet audiovizive përkatëse, bazuar në kërkesat që parashtron neni 51 i ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, rregullores "Mbi procedurat për shqyrtimin e ankesave nga Këshilli i Ankesave dhe të drejtës së përgjigjes", si dhe udhëzimit "Mbi procedurat e trajtimit të ankesave nga

Ofruesit e Shërbimit Mediatik Audioviziv", Këshilli i Ankesave i kërkoi Bordit të Shqyrtimit të Ankesave të televizionit "Klan", paraqitjen e pretendimeve lidhur me ankesën.

Në përgjigjen e vet, nr.1252/01, prot. dt. 10 Nëntor 2022, subjekti audioviziv TV "Klan" pretendonte se "emisioni i datës 16.11.2021 ishte transmetuar para një viti dhe deri më tani nuk ka patur asnjë kontestim prej ankueses. Ndërsa emisioni i datës 12.10.2022, thjesht ka përditësuar informacionin për publikun në lidhje me vendimmarrjen e gjykatës për heqjen e masës së pezullimit që është marrë ndaj avokatit të çështjes së trajtuar në emisionin e parë".

Sipas OSHMA-së "gazetarët e emisionit "Stop" kishin kërkuar të marrin informacion dhe opinionin e gjyqtares, në kuadër të funksionit të saj si nëpunëse publike e angazhuar në çështjet që po investigoheshin në këtë emision.... nuk mund të justifikohet në asnjë rast pretendimi se, gazetari ka patur për qëllim të kryejë ndikim të paligjshëm në kushtet që gazetari po e regjistron bisedën dhe kjo e fundit është transmetuar në media. Në rastin konkret gazetari ka hyrë në oborrin e gjykatës dhe në asnjë rast nuk ka tentuar të hyjë në ambientet e brendshme të saj siç pretendon ankuesja".

Këshilli i Ankesave pas marrjes së pretendimeve të OSHMA-së dhe këqyrjes së vëmendshme të përmbajtjeve audiovizive përkatëse të emisionit "Stop" të transmetuar në datat 16 Nëntor 2021 dhe 12 Tetor 2022,

konstatoi se: "Temat e sjella në formatin satiro-investigativ, trajtonin rastin e ish-prokurorit Emëror Kasaj dhe avokatit Arben Llangozi, të dyja çështje që emisioni i solli në vëmendje bazuar në funksionin publik që ankuesja ushtronte".

Dhe në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga ligji nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë" (neni 4, pika 1/a, b, ç), si dhe Kodit të Transmetimit, miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 228 datë 11.12.2017, sipas të cilit operatorët "Të gjitha lajmet e transmetuara të publikohen në mënyrë objektive dhe të paanshme", (Seksioni 4, pika 4.5). Gazetari, në mënyrë të përsëritur, përmes pyetjeve, kishte kërkuar qëndrimin e ankuses, kundrejt çështjeve të trajtuara në

emision. Edhe nga shqyrtimi i materialeve filmike, rezultoi se gazetari në asnjë moment nuk tentonte të hyjë brenda institucionit, por përpiqej që përmes marrjes së përgjigjes, të trajtonte investigimin, duke paraqitur të gjitha palët.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Nisur nga samësipër, referuar ligjit nr.97/2013 "Për mediat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe Kodit të Transmetimit, miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 228 datë 11.12.2017, Këshilli i Ankesave nuk evidentoi shkelje.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
Këshilli i Lartë Gjyqësor	TV "Klan"	"Stop"	11.11.2022

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Lartë Gjyqësor i nisi një ankesë Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Medias Audiovizive (AMA) në lidhje me emisionin "Stop", transmetuar në televizionin "Klan", në datat 12.10.2022 ora 20:05 ku trajtohej rasti "Shkeljet e gjyqtarës S.D, Gjykata e Lartë e rrëzon, ILD-ja memece" dhe 18.10.2022, rasti "Standardi dyfish i ILD, masë për gjyqtaren e Tik-Tokut, jo për S.D" . Ankuesi pretendonte se "deklaratat në emision në lidhje me çështjen penale në vazhdimësi të hetimit dhe gjykimit janë në cenim të standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare të vendosura në lidhje me lirinë e shprehjes, të garantimit të autoritetit dhe paanshmërisë së gjyqësorit dhe efikasitetit të hetimeve dhe gjykimeve penale, gjatë fazës së hetimit paraprak" si edhe se "raportimet e dhëna mbi çështjen penale konkrete në hetim, janë në tejkallim të kufijve të lejuar në mbrojtje të interesave për administrimin e duhur të drejtësisë dhe pa kontribut në debatin publik në këtë drejtim..." Sipas pretenduesit "autoritetet gjyqësore, gjatë ushtrimit të funksionit të tyre, duhet të ushtrojnë diskrecion në maksimumin e mundshëm, në lidhje me rastet që kanë në gjykim..." dhe se "media kishte detyrimin që të paraqiste informacionin në mënyrë të balancuar dhe jo të shtrembëruar...duke shfaqur edhe qëndrimin e gjyqtarës, me anë të gjyqtarit të medias...".

Gjithashtu, ankuesi pretendonte se "nga gazetarët dhe emisioni është tejkalluar çdo kufi i një kritike të lejuar pasi, duke përçuar në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të nënkuptuar mesazhe diskriminuese si dhe, fyese e shpifëse ndaj gjyqtarës, kanë dëmtuar në mënyrë të pakthyeshme reputacionin e saj si individ..." si edhe se "deklaratat e gazetarëve gjatë emisionit janë qartësisht dhe dukshëm kërcënuese, duke rrezikuar të pasohen me intimidim në kryerjen e funksioneve gjyqësore jo vetëm të gjyqtarës së çështjes në fjalë, por dhe të gjithë aktorëve të tjerë të sistemit".

2. Administrimi i Ankesës

Pas marrjes së ankesës, Këshilli i Ankesave pranë AMA-s, kërkoi Bordit të Shqyrtimit të Ankesave të subjektit audioviziv "TV Klan" paraqitjen e pretendimeve lidhur me ankesën e sipërcituar.

Nëshkresën nr.4098/2Prot, datë 07/12/2022, televizioni sqaroi se "emisioni "Stop" ka bërë publike vendimmarrjen e gjykatës në lidhje me marrjen e masës së sigurimit për palën, që është ankuar pranë emisionit, duke informuar publikun për rastin konkret dhe rrethanat e tij dhe duke iu referuar vendimeve të gjykatës që janë publike dhe të aksesueshme nga kushdo...". Në të njëjtën shkresë pretendohet, se "informacioni i dhënë gjatë emisionit është kufizuar në publikimin

e fakteve që lidhen me një rast të trajtuar më parë nga STOP, për të cilin në datën/periudhën e transmetimit nuk rezulton të ketë patur ndonjë ankesë nga ndonjë palë e interesuar apo e përfshirë në këtë çështje". Po aty sqarohet edhe, se "gazetarët e emisionit "STOP" kanë kërkuar të marrin informacion dhe opinionin e gjyqtares në kuadër të funksionit të saj si nëpunëse publike në përputhje me veprimtarinë që ushtron gazetari për informimin e opinionit publik në mënyrë të paanshme...". Përkitazi pretendimit të ankuesit se "veprimet dhe / apo deklaratat e gazetarëve janë joetike dhe përbëjnë kërcënime, mesazhe diskriminuese, fyese dhe shpifëse ndaj" në shkresë theksohet se ky pretendim "nuk bazohet në asnjë ligj që lidhet me AMA-n...".

Pas shqyrtimit të pretendimeve të paraqitura nga OSHMA-ja dhe këqyrjes së vëmendshme të përmbajtjeve audiovizive përkatëse të emisionit "Stop" (datat 12 dhe 18 Tetor 2022) Këshilli i Ankesave evidentoi se :

- Edicionet e evidentuara nga ankuesi trajtonin rastin e ish – prokurorit E.K, avokatit A. Ll dhe gjyqtares S.D nisur nga funksionet publike që ushtrojnë.
- Në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga ligji nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", (neni 4, pika 1/a, b, ç) dhe Kodi i Transmetimit,

miratuar me vendimin e AMA-s, nr.228 datë 11.12.2017, (Seksioni 4, pika 4.5), gazetari i emisionit kishte informuar publikun për rastin konkret duke iu referuar vendimeve të gjykatës të cilat ishin publike si dhe përmes pyetjeve, kishte kërkuar të marrë opinionin e gjyqtares në kuadër të funksionit publik që ajo ushtronte.

- Nga shqyrtimi i materialeve filmike nuk rezultoi që gazetari të ketë kryer veprime përndjekëse dhe gjeste të natyrës kërcënuese, përveç përpjekjes gazetareske për të bërë pjesë të investigimit edhe opinionin e gjyqtares S.D.

Këshilli i Ankesave konstatoi se:

Komentet dhe gjuha e përdorur nga moderatorët e emisionit në adresë të gjyqtares S.D ishin jo etike, përmbanin fjalor të papërshtatshëm dhe mesazhe diskriminuese.

Qasjet e mësipërme binin ndesh me ligjin nr. nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, (neni 33, pika 1/ç, d), dhe Kodin e Transmetimit, miratuar me vendimin e AMA-s, nr.228, dt.11.12.2017, (seksioni 4, pika 4.7 dhe pika 4.8).

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave pranë AMA-s, tërhoqi vëmendjen për mosrespektimin e dispozitave të sipërcituara dhe i kujtoi detyrimin për ruajtjen e etikës profesionale dhe respektimin e kodit të deontologjisë së gazetarit. Në

rast përsëritjeje, me gjithë respektin për kontributin investigues, që formati jep në sensibilizimin e opinionit publik për ngjarje dhe dukuri problematike të shoqërisë sonë, shkeljet do të penalizohen sipas sanksioneve të përcaktuara në Ligjin nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
Vetë-inicim	TV "RTSH 1"	"Qatar 2022"	07.12.2022

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave, strukturë në përbërje të Autoritetit të Mediave Audiovizive, në kuadër të përmbushjes së detyrimit të vet ligjor për "mbikëqyrjen e zbatimit të kodeve dhe rregulloreve nga OSHMA-të", konstatoi se gjatë emisionit "Qatar 2022", transmetuar në "RTSH 1" në 24 Nëntor 2022, ishte përdorur një shprehje diskriminuese kundrejt komunitet rom dhe egjiptian. Njëri prej të ftuarve, regjisori dhe producenti Petri Bozo, në një përpjekje për të shpjeguar lëvizjen e lojtarëve të futbollit nga një shtet në tjetrin pa pasur rëndësi etnia, përdori termin "jevg", shprehje diskriminuese kundrejt komunitetit rom dhe egjiptian.

2. Administrimi i Ankesës

Nga shqyrtimi i materialit audioviziv, Këshilli i Ankesave konstatoi se ka qenë e menjëhershme ndërhyrja e gazetares së emisionit, znj. Hygerta Sako, e cila ka kërkuar që i ftuari të distancohej nga kjo shprehje,

teksa ky i fundit kishte kërkuar falje në emision.

Paralelisht, Autoriteti i Mediave Audiovizive apeloj OSHMA-në për më shumë sensibilizim dhe kujdes që në programacionet e tyre të shmangen përmbajtje në shkelje të ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe Kodit të Transmetimit, miratuar me vendimin e AMA-s, nr.228, datë 11.12.2017.

Producenti dhe regjisori Petri Bozo pas ndjesës në emision, pati reaguar edhe përmes një deklaratë publike, ku kërkonte ndjesë, duke shprehur se deklarata kishte qenë lapsus dhe nuk kishte pasur sfond racist dhe diskriminues. Komuniteti përsëriti kërkesën publike për ndjesë, por bëri thirrje për më shumë sensibilizim në interes të komunitetit rom dhe egjiptian.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Nisur nga sa më sipër, Këshilli i Ankesave e konsideroi çështjen të ezauruar.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
D.D	TV "Klan"	"Stop"	15.12.2022

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) mori një ankesë nga shtetasja D.D në lidhje me emisionin "Stop", transmetuar në televizionin "Klan" në datën 24 Nëntor 2022. Ankuesja pretendonte se "nga ana e gazetarit emisionit Stop u akuzova qa ua kam shitur njerëzve nja disa herë apartamentet"- dhe se -"Gazetari ka shkuar deri në ofendime".

2. Administrimi i Ankesës

Këshilli i Ankesave filloi administrimin e ankesës duke këqyrur materialin filmik, nga ku shqyrtoi përmbajtjet audiovizive, konkretisht videot e emisioneve të transmetuara në datat 24 dhe ritransmetimin në 25 Nëntor 2022. Shqyrtimi i materialit u krye bazuar në ligjin nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, konkretisht: neni 4, pika 1/b; neni 4 pika 2/d, e; si dhe neni 33, pika 1/b. Paralelisht, u mbajtën në konsideratë edhe detyrimet që rrjedhin nga zbatimi i Kodit të Transmetimit, miratuar nga Bordi i AMA-s, me vendimin 228, datë 11.12.2017 (Seksioni 1, pika 1.1, 1.6; Seksioni 4, pika 4.3, 4.5 dhe 4.13).

Bazuar në sa më sipër, edhe pse Këshilli i Ankesave vlerësoi angazhimin shoqëror të televizionit "Klan" dhe veçanërisht kontributin investigues të emisionit "Stop" në zbardhjen e çështjes së pronësisë së disa banorëve, të një pallati në zonën e "Don Boskos", konstatoi megjithatë se gazetari gjatë trajtimit të temës tejkalon normat ...etike të shoqërisë, si dhe kërkesat e deontologjisë së profesionit të gazetarit. Komentet e gazetarit të emisionit, i cili etiketonte direkt si "mashtroese" dhe "hajdute" nuk përkojnë me formimin e lirë të opinionit, në një kohë, kur përballë në fakt ishin banorët dhe ndërtuesja; çka rrjedhimisht nuk i shërbente as qëllimit, për të nxitur vijimin e hetimit dhe shqyrtimin e plotë të provave nga ana e hetuesisë.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave i risolli në vëmendje emisionit "Stop" dhe televizionit Klan dispozitat e sipërpërmendura të ligjit nr.97/2013 "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe të Kodit të Transmetimit, miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 228 datë 11.12.2017 dhe i kërkoi respektimin e tyre në të ardhmen.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
E.K	TV "Euronews Albania"	"Goodmorning Albanians"	15.12.2022

1. Objekti i Ankesës

Shtetasi E.K i nisi një ankesë Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive në lidhje me emisionin "Goodmorning Albanians", transmetuar në televizionin "Euronews Albania" më datë 15 dhjetor 2022, ora 07.40. Ankuesi pretendonte se "i ftuari dhe prezantuesja diskutojnë, si te ishte një lojë, se në cilat raste do ishte i pranueshëm dënimi me vdekje, duke cituar dhe Kurandin". Ankuesi pretendonte se "Përmbajtje te tilla relativizojnë dhe si pasojë legjitimojnë veprime të pafalshme si vrasja e një personi".

2. Administrimi i Ankesës

Pas marrjes së ankesës, Këshilli shqyrtoi përmbajtjen audiovizive përkatëse, konkretisht videon e emisionit "Goodmorning Albanians", nga ku konstatoi se:

emisioni me titull "A e legjitimon feja islame dënimin me vdekje" kishte pasur në fokus ngjarjet e zhvilluara në Iran dhe protestat e zhvilluara atje ndaj vendimit të shtetit Iranian për dënimin me vdekje të një futbollisti. Për të diskutuar për temën në studio ishin prezentë një teolog, një aktiviste dhe një gazetarë.

Më pas Këshilli i Ankesave iu drejtua Bordit

të Shqyrtimit të Ankesave në televizionin "Euronews Albania", referuar nenit 51 të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, rregullores "Mbi procedurat për shqyrtimin e ankesave nga Këshilli i Ankesave dhe të drejtës së përgjigjes" si edhe udhëzimit "Mbi procedurat e trajtimit të ankesave nga Ofruesit e Shërbimit Mediatik Audioviziv".

Në përgjigjen e vet, "Euronews Albania" argumentoi se "Tema e trajtuar në emision ngrihet në formën e një pyetje për shkak të vendimit të shtetit Iranian që ka shkaktuar debat ku pretendime të tilla ka patur edhe në mediat ndërkombëtare, për këtë moderatorja ka pyetur të ftuarit se si e interpreton feja islame këtë vendim, por në asnjë rast nuk është shprehur apo theksuar se Kurani apo feja islame e legjitimon këtë vendim" dhe se "...televizioni nuk ka patur qëllim të nxisë provokime apo sjellje të papërshtatshëm, të cilat prekin direkt apo indirekt apo dalin kundër një feje të caktuar".

Pas marrjes së pretendimeve të paraqitura nga OSHMA-ja dhe këqyrjes së materialit filmik Këshilli i Ankesave gjatë trajtimit të ankesës nënvizoi detyrimet që rrjedhin nga Ligji nr.97/2013,"Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, (neni 4, pika 2 d dhe dh) si dhe parimet bazë të transmetimit të cilat sanksionohen në aktin nënligjor, Kodi i Transmetimit, Seksioni 1, pika 1.5).

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave, duke vlerësuar rolin e medias në trajtimin e temave të tilla

me interes për publikun i kërkoi mbajtjen parasysh dhe respektimin e parimeve themelore për transmetimin e mediave audiovizive në çdo transmetim të ardhshëm.



Ankesa me objekt

“çenimin e të drejtave

të femijëve”

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
Fondacioni "Down Syndrome Albania" TV "Top Channel"		"Big Brother Vip"	14.05.2022

1. Objekti i Ankesës

Komuniteti i prindërve dhe përfaqësuesit e fondacionit "Down Syndrome Albania" i drejtuan ankesa Autoritetit të Mediave Audiovizive, me pretendimin se në formatin televiziv "Big Brother Vip", në televizionin "Top Channel", transmetuar në datat 21 dhe 22 Nëntor 2021, në komunikim mes banorëve ishin përdorur shprehje që cenonin dinjitetin dhe nxisnin diskriminim ndaj personave me aftësi të kufizuar.

2. Administrimi i Ankesës

Pas shqyrtimit të përmbajtjeve audiovizive përkatëse, Këshilli i Ankesave konstatoi disa formulime "stigmatizuese për personat me sindromën Down". Autoriteti i solli në vëmendje televizionit "Top Channel" detyrimet e OSHMA-ve për respektimin e diversitetit dhe promovimin e personave me

aftësi ndryshe referuar Ligjit 97/2013 (neni 33, pika 1/ç).

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Në kushte pamundësie procedurale për verifikimin e përmbajtjes audiovizive përkatëse – pasi regjistrimi i transmetimit nuk u vu në dispozicion brenda afateve ligjore nga televizioni "Top Channel" – Këshilli i Ankesave pranë AMA-s mbështeti reagimin e Fondacionit "Down Syndrome Albania", në mbrojtje të dinjitetit, mosdiskriminimit, gjithëpërfshirjes dhe të gjitha të drejtave themelore të individit dhe tërhoqi vëmendjen, për nivel më të lartë ndërgjegjësimit dhe ndjeshmërie në qasjet editoriale dhe formulimet përkitazi jo vetëm personave me sindromën Down, por të gjitha shtresave dhe grupeve shoqërore vulnerabël në përgjithësi, përbën standard të rëndësishëm përgjegjësie ligjore dhe profesionale në kuadrin e shërbimeve audiovizive.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
Me vet -inicism	Disa OSHMA	Kronikë	14.05.202

1. Objekti i Ankesës

Në kuadër të përmbushjes së detyrimit të vet ligjor për "mbikëqyrjen e zbatimit të kodeve dhe rregulloreve nga OSHMA-të", Këshilli i Ankesave ndërmori verifikimin e standardit të pasqyrit mediatic të ngjarjes në Brataj/Selenicë (përfshirë abuzimin e dyshuar seksual të një të miture) dhe pasqyrit mediatic të një atentati të ndodhur në Fushë –Krujë, me pasojë humbjen e jetës së dy personave.

Pas monitorimit me kujdes të raportimeve mediatike nga disa OSHMA, në lidhje me rastin e abuzimit seksual të së miturës 17 - vjeçare në Selenicë dhe atentatit në Fushë Krujë, Këshilli i Ankesave evidentoi përmbajtje problematike.

2. Administrimi i Ankesës

Nga këqyrja e përmbajtjeve audiovizive, rezultoi se, gjatë raportimit të abuzimit të dyshuar seksual të së miturës 17-vjeçare, mediat kishin publikuar të dhëna rrethanore, që mundësuan identifikimin e viktimës së dyshuar, kishin transmetuar intervistën e të atit pa teknologjinë e përshtatshme të mbulimit të identitetit, kishin intervistuar të miturën nga disa media njëkohësisht dhe, ndonëse nuk e kishin transmetuar në edicionet e lajmeve, ishte publikuar në kanal

zyrtar të tyre në "YouTube" intervista e saj e plotë, filmuar përballë dhe pa e trajtuar me teknologjinë e përshtatshme të mbulimit të identitetit.

Këshilli i Ankesave vlerësoi se transmetimet e mësipërme ishin në shkelje të Ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në nenin 4, pika 1/b si dhe standardet që kërkon Kodi i Transmetimit në Seksionin 5, pikat 5.1, 5.2, 5.3, 5.4.

Po kështu, pas shqyrtimit të materialit filmik, në lidhje me transmetimin e pamjeve të skenës së atentatit të ndodhur në Fushë – Krujë, më 17.07.2022, ku mbetën të vrarë tre persona, Këshilli i Ankesave konstatoi se :

- Pamjet e skenës së atentatit ishin transmetuar pa përdorur teknologjinë e përshtatshme për mbulimin e tyre.

Këshilli i Ankesave vlerësoi se kjo formë transmetimi ishte në shkelje të ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në : nenin 4, pika 2/ç; nenin 33 pika 1/dh dhe nenin 46, pika 2/dh si dhe Kodin e Transmetimit (miratuar me vendimin e AMA-s, nr.228, datë 11.12.2017); Seksionin 1, pika 3; Seksionin 3, pika 1; Seksionin 5, pika 5.31.

Në përfundim, Këshilli i Ankesave konstatoi se përmbajtjet e transmetuara nga nëntë OSHMA ishin në shkelje të dyfishtë të Ligjit nr.97/2013 "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe të Kodit të Transmetimit, miratuar nga Bordi i AMA-s, me vendimin 228, datë 11.12.2017.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive i tërhoqi vëmendjen OSHMA-ve për shkelje të Ligjit nr.97/2013 "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe të Kodit të Transmetimit, miratuar nga Bordi i AMA-s, me vendimin 228, datë 11.12.2017 si dhe i kërkoi ndalimin dhe fshirjen e çdo ritransmetimi të materialeve. Gjithashtu, i rikujtoi atyre se përsëritja e shkeljeve të ngjashme do penalizohet sipas sanksioneve ligjore në fuqi.

PARALELISHT ME MARRJEN E MASAVE ADMINISTRATIVE NDAJ NËNTË OSHMA-VE, AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE I DREJTOI NJË SHKRESË DREJTORIT TË POLICISË SË SHTETIT, ME FOKUS "MBROJTJA E INTERESIT MË TË LARTË TË FËMIJËSNË ADMINISTRIMIN E DHËNAVE RRETHANORE, QË MUNDËSOJNË IDENTIFIKIMIN E VIKTIMËS".

"Nisur nga pasqyrimi i përgjithshëm mediatic i ngjarjes së ndodhur në Brataj të Selenicës, ku dyshohet edhe abuzimi seksual i një fëmije 17-vjeçare, Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), mori në shqyrtim përmbajtjet audiovizive përkatëse sipas OSHMA-ve, duke konstatuar, se publikimi i të dhënave rrethanore përkitazi vendbanimit apo përbërjes familjare si edhe intervistimi i të prekurve pa përdorur teknologjinë e përshtatshme të mbulimit, ka mundësuar identifikimin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë të viktimës.

Paralelisht me tërheqjen e vëmendjes së

OSHMA-ve, nisur nga fakti, se si burim i parë i të dhënave rrethanore dhe shoqërore, që zbulojnë identitetin e të prekurve, shërben njoftimi i Policisë së Shtetit, në kuadrin e "Sistemit të integruar të mbrojtjes" dhe "Interesit më të lartë të fëmijës" sipas frymës së ligjit "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës", ju sjellim në vëmendje:

- detyrimin mbarëshoqëror "për të mbrojtur në të gjitha situatat privatësinë e fëmijës" (Ligji 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës", Neni 17/Pika 2) dhe për të mos publikuar "të dhënat personale të fëmijës gjatë zhvillimit të procedurave administrative e gjyqësore" (Neni 29/Pika 6),
- detyrimin e agjencive ligjzbatuese për të mos publikuar "asnjë informacion, që mund të çojë në identifikimin e të miturit ... viktimë ose dëshmitar të një veprë penale" (Ligji 37/2017, Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur, Neni 21/Pika 2),
- detyrimin e organeve të Policisë së Shtetit, që përpunimin e të dhënave personale ta kufizojë "vetëm në të dhënat e nevojshme për ndalimin e një rreziku real ndaj rendit e sigurisë publike si dhe për parandalimin, zbulimin, ndjekjen dhe hetimin e veprave penale" (Ligji 108/2014 "Për policinë e shtetit", Neni 124/Pika 1).

Duke besuar, se angazhimi ynë i përbashkët në kuadrin e sistemit të integruar të mbrojtjes së interesit më të lartë të fëmijës do të arrijë në të ardhmen të bëjë diferencën me praktikatat shmangëse të të menduarit dhe vepruarit në këtë kuadër".

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
Dhjetëra ankues	"TV1Channel"	Film	09.09.2022

1. Objekti i Ankesës

Dhjetëra ankues i shkruajtën Autoritetit të Mediave Audiovizive, me pretendimin se në televizionin "TV1 Channel", më datë 09.09.2022, në orarin 11:00-13:00 ishte transmetuar një film me "skena porno... skena erotike... në orar dreke...".

2. Administrimi i Ankesës

Për trajtimin e ankesës, Këshilli i Ankesave iu drejtua OSHMA-së me kërkesën për vënien në dispozicion të materialit audioviziv përkatës. Kërkesë, kjo bazuar në ligjin nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 37, "Regjistrimi i transmetimeve", pika 3. Në përgjigjen e vet, OSHMA-ja bëri me dije se "për shkak të problemeve me energjinë elektrike për disa ditë me radhë, si shkak

i motit të keq, keni pasur probleme me regjistrimin e programacionit".

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) vlerësoi se rrethanat e sipërcituara nuk përbënin arsye justifikuese për mosrespektimin nga ana e OSHMA-së të detyrimeve të përcaktuara nga neni 37/pika 1,2,3 e Ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, për sa kohë në të njëjtën kohë ka qenë i mundur vijimi i transmetimit. Për mosplotësim të detyrimit ligjor për regjistrimin e transmetimeve (ligji nr.97/2013, neni 37/pika 1,2,3), Këshilli i Ankesave tërhoqi vëmendjen në mënyrë paralajmëruese dhe i bëri me dije se në çdo rast ripërsëritjeje, do të penalizohej sipas legjislacionit në fuqi.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
Vetë- inicim	TV "Vizion Plus"	"Armiku i Popullit"	12.09.2022

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave si strukturë mbikëqyrëse e zbatimit të Ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Kodit të Transmetimit, miratuar nga Bordi i AMA-s, me vendimin 228, datë 11.12.2017 dhe rregulloreve, të miratuara nga AMA, evidentoi përmbajtje problematike në promon e emisionit komik/satirik "Armiku i Popullit", transmetuar në televizionin "Vizion Plus", nga data 12 Shtator 2022 e në vijim.

2. Administrimi i Ankesës

Në kuadër të trajtimit të materialit, shqyrtoi përmbajtjen audiovizive nga ku rezultoi se promoja përmbante fjalor jo etik "seks..... seks prapë..."; dhe skena të papërshtatshme, të cilat binin ndesh me normat morale dhe etike në programet e ofruesve të shërbimeve audiovizive. Gjithashtu evidentoi faktin se promoja e emisionit transmetohej gjatë gjithë ditës dhe në orare që mund të

ndiqeshin edhe nga të miturit.

Për pasojë ishte shkelur Ligji nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në : nenin 33, pika 1/d); nenin 46, pika 2/c) po aty, pika 2/dh) si dhe referencat qw gjejnë trajtim edhe në Kodin e Transmetimit, përkatësisht Seksioni 5, pikat 5.34 dhe 5.36.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave i tërhoqi vëmendjen OSHMA-së për shkelje të Ligjit nr.97/2013 "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe Kodit të Transmetimit, miratuar me vendimin e AMA-s, nr.228, datë 11.12.2017, si dhe i kërkoi marrjen e masave të duhura dhe të plota teknike për të censuruar fjalorin e papërshtatshëm dhe skenat që tejkalonin etikën e komunikimit si dhe i kërkoi fshirjen e materialit audioviziv nga llogaria juaj në YouTube dhe çdo prani tjetër online i rikujtoi, se përsëritja e shkeljeve të ngjashme do të penalizohej sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
Agjencia Shtetërore për të Drejtat TV "Top Channel" dhe Mbrojtjen e Fëmijës (ASHMDF)		"Shqipëria Live"	15.09.2022

1. Objekti i Ankesës

Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës (ASHMDF) iu drejtua Autoritetit të Mediave Audiovizive me një ankesë, në lidhje me emisionin "Shqipëria Live", transmetuar në televizionin "Top Channel", më datë 14 Shtator 2022, ora 12:45 – 14:45. Ankuesit pretendonin se "përmes transmetimit të historisë së fëmijës 11 vjeçar i cili për arsye ekonomike të familjes së tij ka qenë i detyruar të shesë lule në rrugë që në moshën 7 vjeçare, rrezikon të krijojë idenë e miratimit dhe promovimit të veprimeve dhe punës së fëmijëve në rrugë dhe si dhe bie ndesh me nenin 24 të Ligjit nr.18/2017, "Për të drejtat dhe Mbrojtjen e fëmijëve".

2. Administrimi i Ankesës

Këshilli i Ankesave shqyrtoi fillimisht përmbajtjen audiovizive referuar nga ankesa, nga ku konstatoi se portretizimi i një fëmije 11 vjeç i cili nga dëshira e madhe për shkollim dhe pamundësia financiare e familjes për të blerë librat, kishte qenë i detyruar të shesë lule në rrugët e qytetit të Tiranës. Nga këqyrja e materialit filmik, rezultoi se intervistimi i fëmijës 11-vjeçar bëhej në prani të së ëmës. Në vijim të ankesës, referuar nenit 51 të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat

audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, rregullores "Mbi procedurat për shqyrtimin e ankesave nga Këshilli i Ankesave dhe të drejtës së përgjigjes" si edhe udhëzimit "Mbi procedurat e trajtimit të ankesave nga Ofruesit e Shërbimit Mediatik Audioviziv", i kërkoi OSHMA-së paraqitjen e pretendimeve. OSHMA-ja, në kthim-përgjigjen e vet argumentoi se "Trajtimi i rastit nga emisioni "Shqipëria Live" ka pasur si qëllim evidentimin e dëshirës së fëmijës për shkollim dhe detyrimin që ka shoqëria dhe shteti për dhënien e kësaj mundësie të gjithë fëmijëve, veçanërisht atyre në nevojë". Bordi i Shqyrtimit të ankesave pranë televizioni "Top Channel" deklaroi gjithashtu se i kishte siguruar fëmijës nëpërmjet donatorëve (gjatë transmetimit live të emisionit) kurse të mësimit të gjuhës angleze dhe futbollit si edhe ndihmë financiare, duke siguruar vazhdimin e qetë të shkollimit të tij, të cilin nuk e kishte pasur deri në momentin, që ishte bërë pjesë e programit.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Ndonëse u mbajt në konsideratë dhe u vlerësua roli i medias në sensibilizimin e autoriteteve shtetërore për ushtrimin e detyrave dhe përgjegjësiive ligjore për arsimimin dhe mirëqenien e fëmijëve si edhe ndihmesën/ndërmjetësimin në garantimin

e një të ardhmeje më të mirë, në rastin individual të 11-vjeçarit, Këshilli Ankesave i bëri thirrje për më shumë ndjeshmëri dhe kujdes në trajtimin e rasteve të tilla, me synim shmangien e shndërrimit të rastit në model për: spostimin e përgjegjësisë nga institucionet te pjesa tjetër e shoqërisë dhe nxitjen dhe përhapjen e modelit të punësimit dhe/ose shfrytëzimit të fëmijëve edhe nëpërmjet ushqimit të shpresës, se në këtë rrugë mund të tërhiqet vëmendja dhe kontributi i shoqërisë për ta. Më tej,

duke iu referuar parimeve themelore për veprimtarinë e transmetimeve audiovizive, me fokuste "të drejtat, interesat dhe kërkesat morale e ligjore për mbrojtjen e të miturve". (Ligji nr.97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Neni 4, pika 1/b), Këshilli i Ankesave i kërkoi që në çdo transmetim në të ardhmen të mbante parasysh "interesin më të lartë të fëmijës" (ligji 37/2017 "Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur", neni 10/pika 2), apeloj për më shumë ndjeshmëri në trajtimin e këtyre temave.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
K.A	TV "RTSH1"	"Ditë pas dite"	19.09.2022

1. Objekti i Ankesës

K.A i drejtoi një ankesë Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive, me pretendimin se në emisionin "Ditë pas dite", transmetuar në "RTSH1", në datën 18.09.2022, ora 17:00, ishte transmetuar përmbajtje e papërshtatshme. Ankuesi pretendonte se një përmbajtje e tillë audiovizive ishte "e paarsyeshme për transmetim sidomos për personazhin dhe për ato që ai shfaq në rrjete sociale të cilat bien në kundërshtim me kodin etik dhe moral të shoqërisë".

2. Administrimi i Ankesës

Pas shqyrtimit të materialit audioviziv, Këshilli i Ankesave zhvilloi një bisedë këshilluese me autorët e emisionit "Ditë pas dite", transmetuar në Radio Televizionin

Shqiptar. Këshilli, si strukturë në përbërje të Autoritetit të Mediave Audiovizive, i kujtoi autorëve parimet dhe detyrimet e OSHMA-ve në përmbushje të misionit mediatik, nisur edhe nga fakti se këto formate televizive iu drejtohen kryesisht të rinjve dhe të rejave dhe se imazhi që iu përcillet atyre rrezikon që të shndërrohet në model sjelljeje edhe për të miturit, duke mbajtur në konsideratë faktin se orari i transmetimit mundësonte lehtësisht ndjekjen e tij edhe nga të miturit.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave u kërkoi autorëve ndjeshmëri dhe zbatimin rigoroz të kërkesave të legjislacionit, me fokus kryesor mbrojtjen e interesit më të lartë të fëmijës si dhe apeloj ata për rishikimin e çdo përmbajtje audiovizive në kuadër të zbatimit të dispozitave ligjore në fuqi.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
E.H	"RTV Ora"	Promo	20.09.2022

1. Objekti i Ankesës

Pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive mbërriti një ankesë-kërkesë nga E.H, i cili kërkonte informacion nëse përmbajtja e promos së emisionit "D-night", transmetuar në radiotelevizionin "Ora", ishte konform rregullave dhe parimeve të parashikuara nga legjislacioni për mediat audiovizive dhe Kodi i Transmetimit.

2. Administrimi i Ankesës

Pas shqyrtimit të materialit audioviziv, Këshilli i Ankesave konstatoi se "përfshirja e një të mituri në rol gjysëm protagonist në spotin promovues të një emisioni për të rritur, bie ndesh me parashikimet ligjore, pasi promoja, e cila parashikohej të transmetohej pa kufizim orari, duhej gjithsesi t'i nënshtrohej programacionit në orarin 06.00-22.00, edhe pse vetë formati transmetohet jashtë këtyre orareve.

Nga këqyrja e materialit filmik, rezultoi gjithashtu se veshja e të miturit-personazh me interesa, që e kapërcenin moshën e tij kundrejt protagonistes në promo, referuar mundësisë së pashmangshme të ndjekjes së tij edhe nga fëmijët për shkak të orarit

dhe shpeshëtisë së transmetimit për qëllime promovimi, u trajtua sipas Kodit të Transmetimit, (Seksioni 1, pika 1.4; Seksioni 5, pika 5.36).

Në të njëjtën kohë, Këshilli evidentoi se promovimi i duhanpirjes si tregues sensualiteti, referuar Kodit të Transmetimit (Seksioni 5, pika 5.25), ndalon reklamën të paraqesin fëmijë apo të rritur në prani të fëmijëve duke konsumuar alkool duhan apo substanca të tjera të dëmshme.

Po në rastin konkret, për të gjitha arsyet e sipërpërmendura, duhet të mbahej në vëmendje edhe ligji nr. 9636, 'Për mbrojtjen e shëndetit publik nga produktet e duhanit' (Neni 13), sipas të cilit "Ndalohen reklama dhe promovimi i produkteve të duhanit nëpërmjet medias së shkruar, transmetimeve televizive e radiofonike dhe shërbimeve të shoqërive të informacionit. Ndalohen reklama dhe promovimi i çdo lloji dhe forme tjetër të produkteve të duhanit..."

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Në përgjigje të kërkesës së Bordit të OSHMA-së, Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive, rekomandoi rishikimin e përmbajtjes audiovizive bazuar në dispozitat e sipërpërmendura.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
Me vetë -inim	TV "Top Channel"	"Shqipëria Live"	30.09.2022

1. Objekti i Ankesës

Nxitur nga reagime të qytetarëve në Autoritetin të Mediave Audiovizive, AMA, por dhe në kuadër të procesit të monitorimit dhe shqyrtimit të përmbajtjeve të transmetuara nga OSHMA-të, referuar kërkesave të ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Këshilli i Ankesave pranë AMA-s, kreu një verifikim, prej të cilit rezultoi se në emisionin "Shqipëria Live", transmetuar në televizionin "Top Channel" më datë 26.09.2022 ora 12:45-14:45, ishte zhvilluar një intervistë me një të mitur, me rastin e publikimit të këngës së tij "Gucci Man".

2. Administrimi i Ankesës

Pas këqyrjes së përmbajtjes audiovizive, Këshilli i Ankesave vuri re se:

- "Intervista e të miturit – përjashtuar dy pyetjeve të lidhura me fillimin e vitit shkollor – jo vetëm që tejkalon zhvillimin psiko-fizik të fëmijës, por e vë atë edhe përballë pyetjeve sugjeruese për përgjigjen vijuese të të miturit, duke e vënë atë në një situatë të pakontrollueshme prej atij vetë".
- "Intervistimi i të miturit shoqërohet

me pamjet e videoklipit të këngës së 6-vjeçarit në ledëall-in e studios, ku ai shfaqet i filmuar në sfond apo/ dhe brenda makinash të shtrenjta, i maskuar në fytyrë dhe i rrethuar me balerina që kërcejnë – të gjitha plane dhe role të papërshtatshme për moshën e fëmijës".

- "Imazhi i të miturit, veçanërisht në videoklip "keqpërdoret" për të promovuar një stil jete të bazuar në luks sipërfaqësor dhe mbjellë arrogancë sociale".
- "Të miturit në emision i kërkohet edhe të këndojë live një pjesë nga kënga e tij, gjatë së cilës ai përsërit edhe në studio fjalët: "Pare, pare bos, nuk na ndal as policia...", duke përsëritur keqpërdorjen e tij si edhe duke rrezikuar që ai të shndërrohet në model të rrezikshëm sjelljeje për të gjithë fëmijët e asaj moshe dhe më gjerë".

Bazuar në konstatimet e mësipërme u evidentuan shkelje të dispozitave të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në nenin 4, pika 1/b si dhe parimet e sanksionuara në Kodin e Transmetimit, (miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 228 datë 11.12.2017), të përcaktuara në (Seksionin 1, pika 1.16), (Seksionin 5, pika 5.8, 5.16, 5.30, 5.36 dhe 5.38).

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave tërhoqi vëmendjen për shkelje të ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Kodit të Transmetimit, miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 228 datë 11.12.2017 dhe deontologjisë së profesionit, për shkak

të shpërfilljes së interesit më të lartë të fëmijës dhe transmetimin e përmbajtjeve audiovizive, që mund të dëmtojnë seriozisht zhvillimin fizik, mendor ose moral të fëmijëve. Gjithashtu i kërkoi heqjen e menjëhershme të përmbajtjes audiovizive përkatëse nga (ri) transmetimi si edhe kanali zyrtar i OSHMA-së në Youtube.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
Nisma "S'ka ma turp" (dhjetëra ankues dhe petition online)	TV "Top Channel" TV "Ora News" TV Klan	"Për 'puthën" "Kepi i tundimeve" "D-Night" "Klanifornia"	10.10.2022

1. Objekti i Ankesës

Në Këshillin e Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) mbërriti ankesë nga z.Fabian Zhilla, përfaqësues dhe kreu i grupit nismëtar të peticionit dhe nismës "S'ka ma turp!" në lidhje me disa formate "Reality Show" dhe jo vetëm, si: "Big Brother VIP" – transmetuar në televizionin "Top Channel", "Kepi i Tundimeve" – transmetuar në televizionin "Top Channel", "Për' puthen" – transmetuar në televizionin "Top Channel", "Dance Albania" – transmetuar në televizionin Klan, "Style Star Show" – transmetuar në televizionin "ABC News", "Love Story" – transmetuar në televizionin "Klan" etj., me pretendimin se formatet e tyre ishin në shkelje të ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe Kodit të Transmetimit, miratuar nga Bordi i AMA-s, me vendimin 228, datë 11.12.2017.

2. Administrimi i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) i mori në shqyrtim të hollësishëm të gjitha përmbajtjet audiovizive të formateve të referuara në

ankesë, duke u përqendruar te përmbajtjet objekt i ankesës.

Pas këqyrjes së përmbajtjeve audiovizive të formatit "D-Night", Këshilli i Ankesave konstatoi, se: "në edicionin e transmetuar në TV ORA në datën 29 Shtator 2022, në orën 23:00, drejtuesja e emisionit, përtej çdo norme etike ofronte si ekskluzive videon e dhunimit degradues të të ftuarit me aftësi të kufizuara, tërësisht të identifikueshëm, për shkak të pranisë në studio, duke përshkruar edhe verbalisht atë ("Një komshi i Edisonit tenton të urinojë në gojën e Edisonit").

Pavarësisht orarit të transmetimit, pavarësisht përpjekjes shumë të zbehtë për të justifikuar ekspozimin me nevojën për sensibilizim në interes të të dhunuarit, Këshilli i Ankesave e vlerësoi këtë përmbajtje në shkelje të Ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", (neni 4, pika 1/b; neni 33, pika 1/ç, d) si dhe Kodit të Transmetimit, miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 228 datë 11.12.2017, përkatësisht në Seksionin 1, pika 1.3, 1.6, Seksioni 6, pika 6.4, 6.8.

Në vijim të shqyrtimit të përmbajtjeve audiovizive u këqyrën materialet e emisioneve "Kepi i Tundimeve" dhe "Për' puthen", prej të cilave Këshilli i Ankesave konstatoi se:

- episodet e emisioneve "Kepi i Tun-dimeve" dhe "Për' puthen" përmbanin komunikim verbal dhe gjeste me kuptim apo nënkuptim erotik dhe shkelje të etikës së komunikimit.
- në këto formate televizive, ku pjesëmarrësit janë të rinj dhe të reja, imazhi që përcillej rrezikon të shndërrohet në model të pandërgjegjshëm sjelljeje për fëmijët, duke patur parasysh orarin e transmetimit, kur ndjekës janë edhe të miturit.
- edhe pse në disa raste ndërhyhet me teknika te posaçme në postproduksion, përmbajtja për orarin, kur transmetohet, mbetet e papërshtatshme. Akoma më shqetësuese situata bëhet kur emisioni ritransmetohet të nesërmen në mesdite, rreth orës 12.45, kur para ekranit është gjithë familja, përfshirë fëmijët.
- Në orën 22:19:24, në emision paraqitet pikturë e titulluar "Qe baba durët", shpjegimi i së cilës përmban komunikim verbal të papërshtatshëm.
- Në orën 22:33:17, skeçi përmban skena, që promovojnë dhunën si model të zgjidhjes së konflikteve familjare.
- Pavarësisht karakterit argëtues të formatit dhe pranisë së konventionit, përmbajtja për orarin, kur transmetohet, mbetet e papërshtatshme për shkak se rrezikon të shndërrohet në model të pandërgjegjshëm sjelljeje për fëmijët.

Për pasojë, Këshilli i Ankesave e vlerësoi këtë përmbajtje në shkelje të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", neni 4, pika 1/b; neni 33, pika 1/ç, d. Dhe Kodit të Transmetimit, miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 228 datë 11.12.2017, (Seksioni 1, pika 1.3, 1.4, 1.6; Seksioni 5, pika 5.31; pika 5.34, 5.35 dhe 5.37).

Për pasojë, Këshilli i Ankesave e vlerësoi këtë përmbajtje në shkelje të:

ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", (neni 4, pika 1/b; neni 33, pika 1/ç, d). Dhe Kodit të Transmetimit, miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 228 datë 11.12.2017, në Seksionin 1, pika 1.3, 1.4, 1.6; Seksioni 5, pika 5.31, 5.34, 5.35 dhe pika 5.37).

Pas këqyrjes së përmbajtjes audiovizive të emisionit "Klanifornia", transmetuar në "TV Klan", Këshilli i Ankesave konstatoi se:

Referuar "D-Nigt" – TV Ora:

Këshilli i Ankesave i tërhoqi vëmendjen për shkelje të ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Kodit të Transmetimit, miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 228 datë 11.12.2017 dhe deontologjisë së profesionit dhe kërkoi heqjen e menjëhershme të përmbajtjeve audiovizive përkatëse nga (ri)transmetimi si

edhe kanali përkatës zyrtar në Youtube. Nisur nga fakti, që vërejtja ishte e përsëritur (Tërheqje vëmendje, nr.3888prot., dt. 21.10.2022), Këshilli i Ankesave paralajmëroi, se nëse këto praktika nuk ndërpriteshin, AMA e paralajmëroi se do të niste procedurat administrative sipas legjislacionit në fuqi.

Referuar "Kepi i tundimeve" dhe "Për'puthen" – TOP Channel:

Këshilli i Ankesave tërhoqi vëmendjen për shkelje të ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Kodit të Transmetimit, miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 228 datë 11.12.2017 dhe deontologjisë së profesionit, për shkak të shpërfilljes së interesit më të lartë të fëmijës dhe transmetimin në orar të papërshtatshëm të përmbajtjeve audiovizive, që mund të dëmtojnë seriozisht zhvillimin fizik, mendor ose moral të fëmijëve si edhe kërkoi në emër të interesit më të lartë të fëmijëve dhe mbrojtjes së tyre nga efektet negative të ndjekjes së këtyre programeve:

- shtyrjen e orarit të transmetimit në fashat e parashikuara nga ligji ("Kepi i tundimeve")
- aplikimin e sinjalistikës në fashat orare, kur ndjekës janë edhe fëmijët ("Për'puthen")
- mbrojtjen e interesit të lartë të fëmijëve prej efekteve negative të ndjekjes së këtyre programeve.
- heqjen e menjëhershme të përmbajtjeve audiovizive përkatëse

nga (ri)transmetimi si edhe kanali përkatës zyrtar në Youtube.

Nisur nga fakti, që vërejtja ishte e përsëritur ("Pamjedhekomunikimetëpapërshtatshme", nr.3085prot., dt. 22.08.2022 dhe "Tërheqje vëmendje", nr.408prot.dt. 20.01.2022), Këshilli i Ankesave paralajmëroi, se nëse këto praktika nuk ndërpritën, AMA do të nisë procedurat administrative sipas legjislacionit në fuqi.

Referuar "Klanifornia" – TV Klan:

Këshilli i Ankesave pranë AMA-s, i tërhoqi vëmendjen për shkelje të ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Kodit të Transmetimit, miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 228 datë 11.12.2017, për shkak të shpërfilljes së interesit më të lartë të fëmijës dhe transmetimin e përmbajtjeve audiovizive, që mund të dëmtojnë seriozisht zhvillimin fizik, mendor ose moral të fëmijëve dhe kërkoi:

- aplikimin e sinjalistikës për përmbajtjet e papërshtatshme, që mbeten në fashat orare, kur ndjekës janë edhe fëmijët
- mbrojtjen e interesit të lartë të fëmijëve prej efekteve negative të ndjekjes së këtyre programeve.
- heqjen e përmbajtjeve audiovizive përkatëse nga (ri)transmetimi si edhe nga kanali përkatës zyrtar në Youtube.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
Dhjetëra ankues	TV "Top Channel"	"Për'puthen"	14.12.2022

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), mori ankesa të shumta në lidhje me emisionin "Për'puthen", transmetuar në televizionin "Top Channel", më datë 14 Dhjetor 2022. Ankuesit pretendonin se "Në një televizion kombëtar në një orar ku të gjithë shikojnë s'duhet të kemi skena dhune falas.... Fjalori që përdorin, diskutimet denigruese, gjuha agresive e të gjithë pjesëmarrësve,etj."

2. Administrimi i Ankesës

Këshilli i Ankesave, shqyrtoi përmbajtjen audiovizive përkatëse, konkretisht dialogun mes protagonistëve në studio dhe referuar ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", konstatoi se gjuha e përdorur ishte në shkelje të dispozitave ligjore, konkretisht nenit 4, pika 2/d, dh; nenit 32, pika 4; nenit 33, pika 1/ç, d; nenit 46, pika 2/dh. Norma dhe parime të sanksionuara edhe në aktin nënligjor, Kodi i Transmetimit, në (Seksionin 1, pika 1.1, 1.3, 1.4, 1.5, 1.6, 1.13, 1.16; Seksioni 5, pika 5.30, 5.31, 5.34, 5.35, 5.36, 5.40, 5.44). Gjatë shqyrtimit të materialit filmik por edhe programin televiziv, Këshilli i

Ankesave gjykoj se edhe pse një format "talk show" i menduar si vendtakim mes të rinjve, për të gjetur dashurinë e tyre, komunikimi i lejuar në studio dhe jashtë në takime, nuk ishte i përshtatshëm për transmetim për orarin e shfaqjes apo për mesazhin e përcjellë në një televizion kombëtar. Referuar episodit, ishte fakt që në shumë raste, komunikimi nga pjesëmarrësit nuk ishte kundërshtuar as nga moderatoresha dhe opinionistët, që nuk dënuan komentet fyese dhe situatat që nxisin intolerancën, justifikonin dhunën dhe diskriminim racor dhe nuk respektonin rregullat e etikës. Shkelja e këtyre parimeve ligjore gjatë transmetimit përkatës përbënte nxitje të dhunës, diskriminimit mbi baza gjinore dhe, si e tillë, është e dënueshme me ligj.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave propozoi vendosjen e sanksionit gjorbë ndaj subjektit audioviziv "Top Channel", ndalimin e ritransmetimit të emisionit "Për'puthen" të datës 14 Nëntor 2022, si dhe detyrimin e operatorit për heqjen e videos përkatëse nga kanali i tij zyrtar në Youtube; propozime të cilat u miratuan edhe nga Bordi i AMA-s.

4

Komunikime tregtare

të ndaluara

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
M.V	TV "Klan"	"Piter Pan"	06.05.2022

1. Objekti i Ankesës

Shtetasja M.V i drejtoi një ankesë Autoritetit të Mediave Audiovizive me pretendimin se në emisionin "Piter Pan", transmetuar në televizionin "Klan", në datën 02.05.2022 ishte bërë reklamë e qumështit formulë, produkt që "dëmton shëndetin e të miturve".

2. Administrimi i Ankesës

Pas këqyrjes së materialit filmik dhe shqyrtimit të ankesës, Këshilli i Ankesave konstatoi shkelje të ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar në nenin 46, pika 2, sipas të cilit "reklamata, shitjet e drejtpërdrejta, materialet e shitjeve të drejtpërdrejta, sponsorizimet dhe format e tjera të paraqitjes tregtare, të përdorura në çdo shërbim transmetimi, veçanërisht ato që lidhen me çështje që mund të jenë drejtpërsëdrejti ose jo në interes të të miturve, duhet të ruajnë interesin e tyre, duke pasur kujdes të veçantë për shëndetin e tyre", të njëjtat kufizime përcaktohen edhe në seksionin për reklamata dhe fëmijët në Kodin e Transmetimit.

Për trajtimin e ankesës së mësipërme, Kë-shilli i Ankesave u bazua edhe në ligjin nr. 8528, datë 23.09.1999 "Për nxitjen dhe mbrojtjen e të ushqyerit me gji", i ndryshuar, neni 4: "Prodhuesve dhe shitësve u ndalohej reklama dhe promovimi i produkteve të përcaktuara në nenin 2, pika ç) duke përfshirë këtu paraqitjen speciale, vizuale në ekrane dhe nëpërmjet internetit e mediave sociale, reklamata për ulje çmimi, çmimet stimuluese, shitjet speciale, uljet e çmimit me kushte të veçanta apo dhuratat, "kampionët e produkteve të caktuara", si dhe promovimin e tyre në një qendër shëndetësore apo institucion tjetër të sistemit shtetëror ose privat".

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave i tërhoqi vëmendjen televizionit "Klan" për shkelje të ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe të Kodit të Transmetimit dhe i kërkoi heqjen nga transmetimi të reklamës së këtij produkti.

5

Ankesa jashtë afati

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
E.K	TV "Abc News"	"Piranja"	21.06.2022

1. Objekti i Ankesës

Pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive mbërriti një ankesë nga E.K, e cila pretendonte se në emisionin "Piranja", transmetuar në televizionin "Abc News", më datë 19.04.2022, nga ora 13.00-14.30 ishte dhënë një intervistë e saj, ku pretendonte se "nga gazetarja e Abc Neës e cila me komunikon se një televizion amerikan Abc, në Amerikë kërkon një intervistë, në gjuhën angleze, në lidhje me historinë. Për këtë arsye kam dhënë intervistën, në mirëbesim të plote se do të transmetohej sikundër u informova. Me pas nga faqja juaj, online jam bërë me dije që kjo intervistë do transmetohet ekskluzivisht nga emisioni "Piranjat", në Abc TV. Ky është mashtrim, në kapërcim të marrëdhënies së etikës dhe për rrjedhojë nuk mundet dhe nuk duhet të shfaqet kurrsesi pa miratimin tim dhe në kushtet e keqbesimit dhe dezinformimit".

2. Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Pas shqyrtimit të materialit filmik, Këshilli i Ankesave konstatoi se ankesa ishte jashtë afateve ligjore për trajtimin e saj. Pika 2 e nenit 52 të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar përcakton se "Ankesa duhet të paraqitet në formë të shkruar në Këshillin e Ankesave brenda 30 ditëve nga data e transmetimit, ose kur në rastin e dy ose më shumë transmetimeve të lidhura me njëra –tjetrën, nga data e transmetimit më të vonë". Në kushtet kur ankesa i referohej një transmetimi më datë 19.04.2022, ajo konsiderohej jashtë afateve të përcaktuara nga ligji.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
D.K	"Report TV"	"Pa gjurmë"	27.06.2022

1. Objekti i Ankesës

Shtetasi D.K i drejtoi një ankesë Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive, me pretendimin se në emisionin "Pa gjurmë", transmetuar në Report TV në 14 Janar 2019 "ka ndikuar negativisht në jetën time të përditshme". Ankuesi pretendonte fshirjen e materialeve video nga kanali zyrtar i OSHMA-së në Youtube.

2. Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave shqyrtoi materialin përkatës, nga ku konstatoi se referuar ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, konkretisht neni 52, përcakton se "Ankesa duhet të paraqitet në formë të shkruar në Këshillin e Ankesave brenda 30 ditëve nga data e transmetimit, ose kur në rastin e dy ose më shumë transmetimeve të lidhura me njëra-tjetrën, nga data e transmetimit më të vonë", kërkesa ishte jashtë afateve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi. Sa i takon pretendimit-kërkesës për fshirjen e materialit audioviziv nga kanali "Youtube" i OSHMA-së dhe të derivateve në portale apo edhe në median e shkruar, Këshilli i Ankesave e informoi se, publikimet në mediat online dhe në median e shkruar, janë jashtë juridiksionit të Autoritetit të Mediave Audiovizive, sikurse përcakton neni 2, "Fusha e zbatimit", i Ligjit Nr. 97/2013.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
M.M	TV "Top-Channel"	"Fiks Fare"	18.08.2022

1. Objekti i Ankesës

Shtetasja M.M i drejtoi një ankesë Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive në lidhje me emisionin "Fiks Fare", të transmetuar në televizionin "Top Channel", në 26.02.2019, ora 20:05. Ankuesja pretendonte se "Ky emision më ka dëmtuar imazhin tim si person dhe profesionalisht... më ka shkaktuar stres dhe rënë moralisht".

2. Administrimi i Ankesës dhe Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Pas marrjes së ankesës, Këshilli i Ankesave nisi menjëherë shqyrtimin e saj. Pas verifikimit të përmbajtjes audiovizive u konstatua se kërkesa ishte jashtë afateve ligjore të parashikuara nga legjislacioni në fuqi për trajtimin e saj. Ligji nr.97/2013, nenit 52, saktëson se "Shqyrtimi i ankesave", sipas të cilit "Ankesa duhet të paraqitet në formë të shkruar në Këshillin e Ankesave brenda 30 ditëve nga data e transmetimit, ose kur në rastin e dy ose më shumë transmetimeve të lidhura me njëra-tjetrën, nga data e transmetimit më të vonë", kërkesa ishte jashtë afateve ligjore.

6

Ankesa jashtë

Objektit të veprimtarisë

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
A.I	SuperSport Albania	Shkrim	15.06.2022

1. Objekti i Ankesës

Shtetasi A.I i drejtoi një ankesë Autoritetit të Mediave Audiovizive, në lidhje me një shkrim të publikuar në portalin "Super SportAlbania", në datën 15.06.2022. Ankesi pretendonte se shkrimi përmbante "Ofendim në baza nacionale ku shqiptarët që jetojnë në territorin e Maqedonisë u referohet si maqedonas dhe është ofendim shumë i madh për shqiptarët që jetojnë në Maqedoninë e Veriut".

2. Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave me marrjen e ankesës nisi shqyrtimin e saj. Pas verifikimit të përmbajtjes përkatëse, konstatoi se publikimi ishte kryer në mediat online, çka del jashtë juridiksionit veprues të Autoritetit të Mediave Audiovizive. Referuar Ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, konkretisht neni 2, "Fusha e zbatimit", sanksionohet se "Ky ligj zbatohet për transmetimet audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare dhe shërbimet mbështetëse të tyre. Ky ligj nuk zbatohet për median e shkruar".

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
E.N	TV "Klan"	"Stop"	16.06.2022

1. Objekti i Ankesës

Shtetasja E.N i drejtoi dy ankesa Këshillit të Ankesave, me pretendimin se operatorët e emisionit "Stop", të televizionit "Klan" kishin kryer një filmim të fshehtë ndaj zj.I.N me qëllim diskreditimin e saj.

Ankuesja pretendonte nga Autoriteti i Mediave Audiovizive ndërhyrjen për mos transmetimin e materialit përkatës, deri në përfundim të procesit gjyqësor në të cilën gjendeshin palët.

2. Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Pas marrjes së ankesës, Këshilli i Ankesave informoi ankuesen se moslejimi i transmetimit të filmimit të fshehtë ashtu edhe kërkesa për mostransmetimin e intervistës nga ana e OSHMA-së, del jashtë juridiksionit të Autoritetit të Media-ve Audiovizive. Veprimtaria e të cilit sanksionohet nga ligji nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", neni 2, "Fusha e zbatimit", i cili saktëson se "Ky ligj zbatohet për transmetimet audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare dhe shërbimet mbështetëse të tyre...".

Në zbatim të dispozitës së sipërpërmendur, ankueses iu bë me dije se, Këshilli i Ankesave shqyrton vetëm ankesat, të cilat i referohen transmetimit të përmbajtjeve audiovizive, që përmbajnë shkelje të ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, bazuar në një formularë ankesë e cila duhet të përmbajë të dhëna të sakta jo vetëm për subjektin audioviziv ku është transmetuar materiali, por edhe datën dhe orën e saktë të transmetimit.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
D.K	"Report TV"	"Pa gjurmë"	27.06.2022

1. Objekti i Ankesës

Shtetasi D.K i drejtoi një ankesë Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive, me pretendimin se në emisionin "Pa gjurmë", transmetuar në Report TV në 14 Janar 2019 "ka ndikuar negativisht në jetën time të përditshme". Ankuesi pretendonte fshirjen e materialeve video nga kanali zyrtar i OSHMA-së në Youtube.

2. Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Nga shqyrtimi i materialit, Këshilli i Ankesave konstatoi se publikimi përtej 30 ditëve nga data e transmetimit, ose kur në rastin e dy ose më shumë transmetimeve të lidhura me njëra-tjetrën, nga data e transmetimit më të vonë, del jashtë afateve ligjore të përcaktuara me ligj. Dhe se sa i takon pretendimit-kërkesës për fshirjen e materialit audioviziv nga kanali "Youtube" i OSHMA-së dhe të derivateve në portale apo edhe në median e shkruar, Këshilli i Ankesave e informoi ankuesin, se publikimet në mediat online dhe në median e shkruar, janë jashtë juridiksionit të Autoritetit të Mediave Audiovizive, sikurse përcakton neni 2, "Fusha e zbatimit", i Ligjit Nr. 97/2013.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
O. Xh	"BalkanWeb"	Shkrim	28.06.2022

1. Objekti i Ankesës

O. Xh i drejtoi një ankesë Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive, me pretendimin ishte cenuar privatësia viktimës, kishte shkelje të etikës televizive lidhur me publikimin e një artikulli që tregon pamje tragjike dhe një foto të aksidentuarve, në një aksident të ndodhur në qytetin e Beratit.

2. Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave në kuadër të administrimit të ankesës, shqyrtoi materialin e referuar nga ankuesja, nga ku konstatoi se publikimi ishte bërë nga mediat online. Referuar nenit 2 të ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar ky medium del jashtë juridiksionit veprues të Autoritetit të Mediave Audiovizive.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
Studio Ligjore "Agolli&Co"	Portale dhe rrjete sociale	Shkrime	21.07.2022

1. Objekti i Ankesës

Pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive mbërriti një ankesë nga Studio Ligjore "Agolli&Co", përmes së cilës pretendohet se "në disa rrjete sociale, portale online, media të shkruara dhe rrjete të komunikimeve elektronike janë publikuar të dhëna personale dhe sensitive për ju dhe familjarët tuaj, duke ju cenuar dinjitetin, personalitetin dhe privatësinë me qëllim denigrimin e figurës tuaj". Përfaqësuesit ligjor të ankueses kërkonin nga Autoriteti bllokimin dhe fshirjen e të dhënave personale të përhapura në mënyrë të paligjshme nga këto portale dhe rrjete sociale, paralelisht kërkohej heqja e transkriptimeve që lidheshin me emrin e saj.

2. Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Pas marrjes në shqyrtim të ankesës dhe materialeve referuese, Këshilli i Ankesave verifikoi se përmbajtjet përkatëse ishin publikuar nga portale online dhe rrjete sociale. Për vijimin e shqyrtimit të ankesës, Këshilli e informoi se publikimi në mediat online del jashtë tagrit ligjor të Autoritetit të Mediave Audiovizive. Referuar Ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, konkretisht neni 2, "Fusha e zbatimit", sanksionon se "Ky ligj zbatohet për transmetimet audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare dhe shërbimet mbështetëse të tyre. Ky ligj nuk zbatohet për median e shkruar".

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve	"Albage" Reklamë		09.09.2022

1. Objekti i Ankesës

Elma Tërshana, drejtore e "Observatorit për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve", i drejtoi një ankesë Këshillit të Ankesave, pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive me pretendimin se kompania "Alba Game", "bën reklamë online, në vigjilje të fillimit të vitit të ri shkollor". ankuesja pretendonte se "nuk është aspak e etike dhe me vend realizimi i një reklame të tillë..." dhe se ... "ky mesazh shoqërohet me pamjen e një të riu i cili qëndron i fokusuar në kompjuter duke lozur, pasi dhe vetë kompania që ka ndërtuar këtë imazh është kompani për lojëra online".

2. Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave e informoi ankuesen se publikimi në mediat online del jashtë juridiksionit të Autoritetit të Mediave Audiovizive. Referuar ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, konkretisht neni 2, "Fusha e zbatimit", sanksionohet se "Ky ligj zbatohet për transmetimet audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare dhe shërbimet mbështetëse të tyre. Ky ligj nuk zbatohet për median e shkruar".

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
V.S			08.09.2022

1. Objekti i Ankesës

Shtetasi V.S i drejtoi një ankesë Këshillit të Ankesave, me pretendimin se Radio Televizioni Shqiptar i kishte refuzuar atij dhe subjektit politik "Partia e Mirëqenies Popullore", e përfaqësuar prej tij, të drejtën e fjalës dhe të paraqitjes mediatike të alternativës së tij politike.

2. Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Pas marrjes së ankesës, Këshilli i Ankesave informoi ankuesin se moslejimi i transmetimit të filmimit të fshehtë ashtu edhe kërkesa për intervistim nga ana e OSHMA-së, del jashtë juridiksionit të Autoritetit të Mediave Audiovizive. Veprimtaria e të cilit sanksionohet nga ligji nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", neni 2, "Fusha e zbatimit", i cili saktëson se "Ky ligj zbatohet për transmetimet audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare dhe shërbimet mbështetëse të tyre...". Në zbatim të dispozitës së sipërpërmendur, ankuesit iu bë me dije se, Këshilli i Ankesave shqyrton vetëm ankesat, të cilat i referohen transmetimit të përmbajtjeve audiovizive, që përmbajnë shkelje të ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
R.V	Rrjete sociale	Video	21.09.2022

1. Objekti i Ankesës

Pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive mbërriti një ankesë nga R.V, e cila pretendonte se në "në rrjetin social Facebook, në faqen personale të z.Myslim Murrizi" ishte publikuar video sensibilizuese me protagoniste vajzën e saj 7-vjeçare "me një mbishkrim që nuk kanë lidhje fare me videon".

2. Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Pas shqyrtimit të materialit, Këshilli i Ankesave konstatoi se ankesa del jashtë kompetencave ligjore për trajtimin e saj. Referuar Ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, konkretisht neni 2, "Fusha e zbatimit", sanksionohet se "Ky ligj zbatohet për transmetimet audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare dhe shërbimet mbështetëse të tyre. Ky ligj nuk zbatohet për median e shkruar". Ankueses iu bë me dije se trajtimi administrativ i ankesës del jashtë kompetencave të Autoritetit.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
E.D	Tik -Tok	Video	12.09.2022

1. Objekti i Ankesës

Shtetasi E.D i drejtoi një ankesë –kërkesë, përmes se cilës pretendonte nga Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), "të bllokojë audion dhe të mos publikohet videoja e fëmijës".

2. Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Pas marrjes së ankesës, Këshilli i Ankesave nisi shqyrtimin e saj. Pas verifikimit u evidentua se përmbajtja e referuar lidhej me publikimin e një videoje në platformën online "TikTok". Referuar ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, konkretisht neni 2, "Fusha e zbatimit", përcakton se "Ky ligj zbatohet për transmetimet audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare dhe shërbimet mbështetëse të tyre. Ky ligj nuk zbatohet për mediane e shkruar". Në kthim-përgjigjen ndaj ankuesit, Këshilli i Ankesave e informoi se publikimi në mediat dhe platformat online del jashtë juridiksionit të Autoritetit të Mediave Audiovizive.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
M.P	Rrjete sociale	Shkrime	28.09.2022

1. Objekti i Ankesës

Shtetasja M.P i drejtoi një ankesë Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive me pretendimin se, pa miratimin e saj, në portale, median e shkruar dhe rrjetet sociale "Facebook" dhe "Instagram" ishin publikuar shkrime, foto të fëmijës së saj.

2. Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Në kuadër të trajtimit të ankesës, Këshilli i Ankesave konstatoi se materialet ishin publikuar në mediat online, shtypin e shkruar dhe rrjetet sociale; çka del jashtë kompetencave juridike të punës së Autoritetit të Mediave Audiovizive. Ligji nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, konkretisht neni 2, "Fusha e zbatimit", sanksion pikërisht se: "Ky ligj zbatohet për transmetimet audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare dhe shërbimet mbështetëse të tyre". Këshilli i Ankesave shqyrton çdo ankesë, lidhur me transmetimin e lajmeve dhe programeve në shkelje të kërkesave të nenit 33 të Ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar në bazë të një formulari ankese i cili përcakton saktësisht subjektin audioviziv ku është transmetuar materiali si dhe datën dhe orën e saktë të transmetimit.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
G.T	"Instagram"	Komente	19.10.2022

1. Objekti i Ankesës

Shtetasja G.T i drejtoi një ankesë Këshillit të Ankesave, me pretendimin se "një adresë me emrin "E.Z" në "Instagram"- ka bërë komente fyese si dhe -"ka dërguar mesazhe duke vijuar ofendimet".

2. Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Pas marrjes së ankesës, Këshilli i Ankesave konstatoi se publikimi i materialeve referuar nga ankuesja ishin bërë në medime të cilat nuk mbulohej nga fusha ligjore vepruese e AMA-s. Për sa më sipër, ankueses iu bë me dije se publikimi në mediat online, shtypin e shkruar dhe rrjetet sociale nuk janë në juridiksionin e Autoritetit të Mediave Audiovizive. Ligji nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, konkretisht neni 2, "Fusha e zbatimit", sanksionon pikërisht se: "Ky ligj zbatohet për transmetimet audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare dhe shërbimet mbështetëse të tyre". Paralelisht me këtë, Këshilli i Ankesave e sqaroi ankuesen se kjo strukturë shqyrton çdo ankesë, lidhur me transmetimin e lajmeve dhe programeve në shkelje të kërkesave të nenit 33 të Ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar në bazë të një formulari ankesë i cili përcakton saktësisht subjektin audioviziv ku është transmetuar materiali si dhe datën dhe orën e saktë të transmetimit. Për sa më sipër e sqaroi se ky formular gjendet në anën e djathtë, në faqen zyrtare të Autoritetit të Mediave Audiovizive (ama.gov.al) pas plotësimit, dërgohet me e-mail në adresën elektronike: Gjithashtu, ankesat mund të depozitohen edhe përmes shërbimit postar ose dorazi në zyrën e protokollit pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA).

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
Sh.K	"TikTok"	Video	23.10.2022
	TV "Abc News" (Youtube)	Video	
	TV "Ora News" (Youtube)	Video	

1. Objekti i Ankesës

Në Këshillin e Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) mbërriti një ankesë nga Sh.K i cili pretendonte se në datë 20 Tetor 2022, nga portali "ShiptariOfficial", në rrjetin social "TikTok" ishte publikuar një video me "mesazhe hakmarrje dhe nxitjes së saj kundrejt meje dhe familjes time"- dhe se - "origjinali i kësaj video është postuar në vitin 2013, 29 Dhjetor nga televizionet "Report TV" dhe "Abc News Albania". Ai kërkonte fshirjen e materialit audioviziv nga rrjeti social "Tik Tok" dhe nga kanalet zyrtare në Youtube, të këtyre dy OSHMA-ve.

2. Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Në shqyrtim të ankesës, Këshilli i Ankesave e informoi ankuesin se publikimet në rrjetet sociale dhe platforma e shpërndarjes se videove del jashtë tagrit ligjor veprues të Autoritetit të Mediave Audiovizive dhe kompetencave të Këshillit të Ankesave. Ligji nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, i cili rregullon veprimtarinë e Autoritetit të Mediave Audiovizive përcakton se "Ky ligj zbatohet për transmetimet audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare dhe shërbimet mbështetëse të tyre. Ky ligj nuk zbatohet për median e shkruar", (neni 2, "Fusha e zbatimit").

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
I.B	"Pamfleti"	Shkrime	09.11.2022

1. Objekti i Ankesës

Shtetasi I.B i drejtoi një ankesë Autoritetit të Mediave Audiovizive, në lidhje me një shkrim të publikuar në portalin "Pamfleti", në datën 07.11.2022. Ankuesi pretendonte se shkrimet në fjalë i kishin cenuar rëndë nderin, moralin, integritetin profesional të tij dhe të bashkëshortes.

2. Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave me marrjen e ankesës nisi menjëherë shqyrtimin e saj. Pas verifikimit të përmbajtjes përkatëse, konstatoi se publikimi ishte bërë nga mediat online, çka del jashtë juridiksionit të Autoritetit të Mediave Audiovizive. Referuar ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, konkretisht neni 2, "Fusha e zbatimit", sanksionohet se "Ky ligj zbatohet për transmetimet audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare dhe shërbimet mbështetëse të tyre. Ky ligj nuk zbatohet për median e shkruar".

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
B.L	"Pamfleti"	Shkrime	10.11.2022

1. Objekti i Ankesës

Shtetasi B.L i drejtoi një ankesë Autoritetit të Mediave Audiovizive, në lidhje me disa shkrime të publikuara në portalin "Pamfleti", në datat 07-08-09.11.2022. Ankuesi pretendonte se shkrimet :

"Miku i Ramës e ortak i kartelit të drogës "Sinaloa", Besnik Lulaj, ka marrë 3.4 milionë Euro tendera"

"Koço Kokëdhima, "kumbari" i miqësisë së Edi Ramës me trafikantin Besnik Lulaj të kartelit "Sinaloa"

"Kazino e kartelit të Sinaloas "Marina Bay", prej 3 vitesh ka vetëm 1 punëtor : "lavatriçen"Besnik Lulaj"

"Kush është kulufi "Ido Manekuta" i let-rave të mbyllura, dhe subjekt i ligjit të dekriminalizimit, që po mbron hapur pastrimin e parave të kartelit El Chapo në Vlorë dhe në Shqipëri e zullume të tjera.

"Pogradec / "Xhagajduri" Ilir Xhakolli i jep 1.1 milion euro Besnik Lulajt, ortak i bosëve të "Sinaloa"

"Avokati i grupit mafioz "Sinaloa", Ido Manekuta, kërkon gjobë 500 milion lekë nga "Pamfleti".

Ankuesi pretendonte se shkrimet e publikuara ishin tërësisht të pavërteta, shpifëse dhe fyese duke i kishin cenuar rëndë dinjitetin dhe moralin.

2. Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave me marrjen e ankesës nisi menjëherë shqyrtimin e materialeve. Pas verifikimit të përmbajtjeve referuese, konstatoi se publikimet ishin bërë në mediat online, çka del jashtë juridiksionit të Autoritetit të Mediave Audiovizive. Referuar ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, konkretisht neni 2, "Fusha e zbatimit", sanksionohet se "Ky ligj zbatohet për transmetimet audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare dhe shërbimet mbështetëse të tyre. Ky ligj nuk zbatohet për median e shkruar".

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
A.P	Portali "Forumi shqiptar"	Shkrim	15.12.2022

1. Objekti i Ankesës

Shtetasi A.P i drejtoi një ankesë Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive, në lidhje me një shkrim të publikuar në portalin "Forumi Shqiptar". Ankuesi pretendonte se shkrimi përmbante informacion të pavërtetë dhe dëmtues për imazhin e tij.

2. Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave me marrjen e ankesës nisi menjëherë shqyrtimin e saj. Pas verifikimit të përmbajtjes, konstatoi se publikimi ishte bërë në mediat online, çka del jashtë juridiksionit të Autoritetit të Mediave Audiovizive. Referuar ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, konkretisht neni 2, "Fusha e zbatimit", sanksionohet se "Ky ligj zbatohet për transmetimet audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare dhe shërbimet mbështetëse të tyre. Ky ligj nuk zbatohet për median e shkruar".

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
B.K	Portale	Shkrime	22.12.2022

1. Objekti i Ankesës

Shtetasi B.K i drejtoi një ankesë Autoritetit të Mediave Audiovizive, në lidhje me disa shkrime të publikuara nga portalet: "5 Pyetjet.al", "Gijotina.com", "JOQ Albania", "Dosja.al", "Boldnews.al", "Lajmifundit.al", "Voxnews.al", "Syri.net", "Pamfleti.al", "AlpeNews.al", "Prapaskena.al", në datën 19.12.2022. Ankuesi pretendonte se në shkrime ishte përdorur fotoja e tij si ilustrim për identitetin e një personi të lidhur me një ngjarje të rëndë, me pasojë krimin.

2. Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave me marrjen e ankesës nisi menjëherë shqyrtimin e saj. Pas verifikimit të përmbajtjeve përkatëse, konstatoi se publikimi kishte ndodhur në mediat online, çka bie jashtë juridiksionit të Autoritetit të Mediave Audiovizive. Referuar ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, konkretisht neni 2, "Fusha e zbatimit", sanksionohet se "Ky ligj zbatohet për transmetimet audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare dhe shërbimet mbështetëse të tyre. Ky ligj nuk zbatohet për median e shkruar".

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
KDI	Portale	Shkrime	22.12.2022

1. Objekti i Ankesës

Komisioneri për të Drejtën e Informimit i drejtoi një ankesë Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive, në lidhje me disa shkrime të publikuara në portalet; "5 Pyetjet.al", "Gijotina.com", "JOQ Albania", "Dosja.al", "Boldnews.al", "Lajmifundit.al", "Voxnews.al", "Syri.net", "Pamfleti.al", "AlpeNews.al", "Prapaskena.al", në datën 19.12.2022. Komisioneri pretendonte shkeljen e të drejtës së privatësisë dhe cenimin e të drejtave të njeriut, me publikimin e të dhënave sensitive të shtetasit B.K, përmes të shkrimeve të publikuara nga këto portale.

2. Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Pas marrjes së ankesës, Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) shqyrtoi materialet referuese, prej nga ku rezultoi se portalet: "5 Pyetjet.al", "Gijotina.com", "JOQ Albania", "Dosja.al", "Boldnews.al", "Lajmifundit.al", "Voxnews.al", "Syri.net", "Pamfleti.al", "AlpeNews.al", "Prapaskena.al"; kishin përdorur foton e ankuesit, z. B.K si ilustrim për identitetin e një personi të lidhur me një ngjarje të rëndë, me pasojë krimin.

Këshilli i Ankesave - duke vlerësuar ndjeshmërinë e ankuesit dhe institucionit që ka ngritur shqetësimin në lidhje me publikimet e sipërpërmendura – e informoi se publikimi në mediat online del jashtë juridiksionit të Autoritetit të Mediave Audiovizive. Referuar Ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, konkretisht neni 2, "Fusha e zbatimit", sanksionon se "Ky ligj zbatohet për transmetimet audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare dhe shërbimet mbështetëse të tyre. Ky ligj nuk zbatohet për median e shkruar".

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
T.TH	OSHMA-të	Disa formate	23.12.2022

1. Objekti i Ankesës

Shtetasi T.TH i drejtoi një ankesë Autoritetit të Mediave Audiovizive, në lidhje me disa formate televizive, transmetuar kryesisht nga televizionet kombëtare. Ankuesi pretendonte se në këto formate cenohej rëndë dinjiteti dhe imazhi i kategorive të personave në pamundësi fizike dhe mendore.

2. Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Pas marrjes së ankesës, Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive, e sqaroi ankuesin për fushën e veprimit të legjislacionit të medias si dhe i kërkoi atij plotësimin e të dhënave për vijimin e shqyrtimit të mëtejshëm të problematikës.

